

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6079
E mërkurë, 5 gusht 2020
çmimi 0.40 €

13 të vdekur dhe 225
raste të reja me Covid-19

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

POPULLI SHQIPTAR E NJEH
MIRË UÇK-NË (23) F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



AKTUALE

HOXHAJ: SERBIA PO
ARMATOSËT NGA KINA,
BE-ja ENDE ASNJË FJALË F. 7

BUXHETI, KUSHT PËR NGRITJEN
E KAPACITETEVE TË FSK-së F. 6

LICENCIMI I ÇERDHEVE PRIVATE,
KOMPETENCË E MINISTRISË
SË ARSIMIT F. 6

EKONOMI



OYTETARËT E KOSOVËS U
MASHTRUAN PËR SASINË E
DJATHIT TË PRODHUAR NË
MAQEDONINË E VERIUT F. 8

RRITEN ÇMIMET E PRODHIMEVE
BLEGTORALE DHE BIMORE NË
KOSOVË F. 8

BAJRAMI: PROGRAMI PËR
REFORMA NË EKONOMI
ADRESON EDHE RITJEN E
PUNËSIMIT F. 9

SPORT

'NIKLI' VAZHDON ME RISI,
GRECA TRANSFERI ME I RI F. 16

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI F. 4-5



QEVERIA HOTI PËRBALLË 'CUNAMIT'

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka bërë me dije se qeveria Hoti gjendet në një pozitë të vështirë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se kur procesit të dialogut me Serbinë i shtohet edhe kriza e pandemisë, pozita e qeverisë Hoti është e pashpresë përballë një "cunami" shkatërrues multidimensional. Ai ka vlerësuar se nga ky "cunami" nuk do të mund të shpëtojnë as kritikuesit e kësaj qeverie. Sipas Maliqit, spektri politik duhet të heqë dorë nga interesat e ngushta dhe të bashkohet për t'u ballafaquar me sfidat të cilat e presin Kosovën

QEVERIA SHKARKON BORDET E EMËRUARA NGA KURTI, EMËRON TË HOTIT

Qeveria e Kosovës, e cila drejtohet nga Avdullah Hoti, ka marrë vendim për shkarkimin e bordeve të përkohshme të drejtorëve të katër ndërmarrjeve publike të cilat ishin emëruar nga ish-qeveria Kurti. Pas shkarkimit të bordeve, qeveria ka emëruar anëtarët e rinj në KRU

"Prishtina" "Ibër-Lepenc", KEK dhe në KRU "Hidroregjioni Jugor". Ndaj këtij vendimi ka reaguar ish-ministrja Rozeta Hajdari, e cila i ka akuzuar kryeministrin Hoti dhe ministrin Blerim Kuçi se janë duke punuar në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjet në fuqi



PROJEKTLIGJI PËR UÇK-në DHE AI PËR PANDEMINË
PRITET TË VOTOHEN TË PREMTEN NË KUVEND F. 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Çurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

A do të jenë shqiptarët pjesë e qeverisë serbe?

BEOGRAD, 4 GUSHT - Pas zgjedhjeve të 21 qershorit në Serbi, presidenti Aleksandër Vuçiq dhe përfaqësuesit politikë të shqiptarëve nga jugu i Serbisë duke se kishin gjetur një gjuhë të përbashkët për bashkëpunim. Mirëpo, një pengesë në këtë drejtim është paraqitur pas formimit të qeverisë lokale në Bujanoc, qytet me 12 mijë banorë në jug të Serbisë. Katër parti shqiptare kanë rënë dakord të qeverisin në Bujanoc, pa pjesëmarrjen e partive serbe, kështu që koalicioni i Partisë Përparimtare Serbe (SNS), e cila ka fituar 10 vende dhe Partia Socialiste e Serbisë (SPS) me tre këshilltarë, mbetën në opozitë.

Ky problem që është paraqitur në nivel lokal është zhvendosur edhe në atë qendror, duke çuar në një ftohje të raporteve. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, e ka kritikuar ashpër këtë veprim të forcave politike shqiptare, madje duke deklaruar se hapësira e Serbisë për manovrim në bisedime me Kosovën do të shkurtohet, ndër të tjera, edhe për shkak të "krijimit të një qeverie të vetme shqiptare kundër serbëve në Bujanoc".

Kryetari i Partisë për Veprim Demokratik, njëherësh deputet në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka thënë për "Radion

Evropa e Lirë" se shteti në mënyrë që t'i shmangë tensionet, nuk duhet të ndërhyjë në koalicionet partiake në mjedise shumëkombëshe, por duhet të angazhohet për zgjidhjen e problemeve të tyre. Në Bujanoc, një qytet në jug të Serbisë, 300 kilometra larg Beogradit, që nga viti 2002 pushteti lokal gjithmonë është formuar bashkërisht nga partitë shqiptare dhe serbe. Në këtë vend, sipas të dhënave të fundit, komuniteti shqiptar përbën 65 për qind të popullsisë. Marrëveshja për formimin e shumicës qeverisëse, pas zgjedhjeve të mbajtura më 21 qershor, u arrit nga partitë shqiptare: Partia Demokratike (PD), Partia për Veprim Demokratik (PDD), Lëvizja për Progres Demokratik (PDP) dhe Alternativa për Ndryshim (AZP). Tashmë, Bujanoci është ndër komunat e rralla ku Partia Përparimtare Serbe nuk është në pushtet. Kjo parti do ta formojë qeverinë e ardhshme të Serbisë. Në seancën konstituive të mbajtur më 23 korrik me 25 vota për, Nagip Arifi, kryetar i PD-së, është zgjedhur kryetar i Komunitetit të Bujanocit. Të pakënaqur me formimin e qeverisë lokale njëetnike, këshilltarët e partive serbe u larguan nga seanca. Kjo ka ndodhur vetëm disa ditë pas takimit për formimin e qeverisë



Zemëna FB stranica Aleksandra Vučića (Facebook)

së re ndërmjet delegacionit të partive shqiptare me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në Beograd. Në atë takim, shqiptarët kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në qeveri dhe kanë kërkuar këto pozita: Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, ndihmësministrin e Ekonomisë, sekretarin e shtetit në Ministrinë e Arsimit dhe pozicionin e presidentit të Trupit Koordinues. Megjithatë, pas formimit të qeverisë lokale në Bujanoc, reagimet nga Beogradi kanë qenë të stuhishme, duke

zbehur mundësitë për këtë bashkëpunim. Shaip Kamberi ka thënë se shqiptarët e jugut të Serbisë që nga viti 2001, kur ka përfunduar konflikti i armatosur, gjenden në "një lloj procesi politik herë të vdekur, herë të gjallë", duke pamundësuar zgjidhjen e problemeve jetësore. "Kjo do të thotë se shteti në vazhdimësi shmangte trajtimin e shqiptarëve si partnerë të barabartë, duke pasur një qëndrim negativ ndaj nesh. Ja, edhe tani po përpiqet ta paraqesë formimin e qeverisë në Bujanoc

si një të keqe të përgatitur nga shqiptarët, në mënyrë që t'i justifikojë disa hapa të radhës, të cilët, ndoshta, çojnë në mospranimin tonë si pjesë e qeverisë dhe mosfillimin e një dialogu për planin shtatëpikësh që e kemi kërkuar nga presidenti Vuçiq", ka thënë Kamberi. Ndërsa presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në një prej reagimeve të tij ka sinjalizuar se zhvillimet në Bujanoc mund ta rrezikojnë pranimin e mundshëm të shqiptarëve në Qeverinë e Serbisë.

Bisedimet për qeverinë e re në Maqedoni, Ahmeti: Akoma nuk ka diçka konkrete

Shkup, 4 gusht (ER) - Të martën është konstituuar Kuvendi i Maqedonisë së Veriut. Pas konstituimit, kryetari i Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI), Ali Ahmeti, ka thënë se tani mund të fillojnë bisedimet për koalicionin qeverisës. Pavarësisht kësaj, Ahmeti ka thënë se është herët të flitet për koalicionin dhe se ende nuk ka diçka konkrete në lidhje me bisedimet. "Nga sot gjerat mund të fillojnë për bisedime. Akoma nuk ka diçka konkrete", është shprehur Ahmeti.

Ndërsa kryetari i LSDM-së, Zoran Zaev, i cili është fitues i zgjedhjeve, ka filluar bisedimet për formimin e qeverisë së re, ku është takuar me kryetarin e PDSH-së, Menduh Thaçi. Me këtë rast, Zaevi ka theksuar se është i gatshëm për negociata me të gjitha partitë dhe se të gjitha opsionet janë të hapura.

Ndërsa kryetari i VMRO-së, Hristan Mickoski, ka thënë se është duke bërë përpjekje për formimin e qeverisë së re. Procesi elektorale i ka siguruar shumicën e socialdemokratëve në pushtet të ish-kryeministrit Zoran Zaev, 46 mandate, 2 më shumë sesa opozitarët e VMRO-DPMNE-së. Duke ditur përbërjen e dhomës legjislative me 120 vende, asnjëra prej grupimeve më të mëdha nuk ka marrë mazhorancën parlamentare. Si forca përcaktuese të aleancave politike shihen partitë shqiptare në krye me Bashkimin Demokratik për Integritim (BDI) të Ali Ahmetit. 15 mandatet e BDI-së së bashku me LSDM-në do të formonin një shumicë të brishtë parlamentare dhe do ta mundësonin vijimin e aleancës së shkuar. Mediat kanë raportuar se kusht i shqiptarëve është posti i kryeministrit që,



sipas një teorie, mund t'u jepet atyre në vitin e fundit të katërvjeçarit qeveritar. Një tjetër

grupim etnik, ai i Aleancës për Shqiptarët i Ziadin Selës, ka thënë se nuk i beson Ahmetit dhe se

është duke vazhduar negociatat me aktorë të tjerë politikë për t'i bashkuar 12 mandatet e veta.

Kosova vazhdon të ketë numër të lartë të vdekjeve dhe infektive me Covid-19

13 të vdekur dhe 225 raste të reja me Covid-19



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit kanë ndërruar jetë 13 persona të prekur nga Covid-19. Nga 477 mostra të marra nga ShSKUK-ja, 225 prej tyre kanë rezultuar pozitive me koronavirus, ndërsa 201 persona janë shëruar. Numri më i lartë i të infektuarve është shënuar në Prishtinë, me 93 raste të reja

Prishtinës 93 raste, komuna e Mitrovicës 16 raste, komuna e Gjakovës 14 raste, komuna e Gjilanit 14 raste, komuna e Fushës Kosovës 13 raste, komuna e Drenasit 9 raste, komuna e Ferizajt 8 raste, komuna e Lipjanit 7 raste, komuna e Pejës 7 raste, komuna e Podujevës 7, komuna e Shtimes 6 raste, komuna e Skenderajt 5 raste, komuna e Vitit 5 raste, komuna e Vushtrrisë 4 raste, komuna e Obiliqit 3 raste, komuna e Deçanit 2 raste, komuna e Dragashit 2 raste, komuna e Malishevës 2 raste, komuna e Rahovecit 2 raste,

komuna e Suharekës 2 raste dhe me nga një rast komunat Kamenicë, Kaçanik, Klinë dhe Novobërdë.

BE-ja i dorëzon ShSKUK-së 30 ventilatorë dhe 200 pulsiksometra

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës ka pranuar pajisje shtesë, pjesë e donacionit prej 5 milionë eurosh nga Bashkimi Evropian, për trajtimin e pacientëve të prekur me Covid-19. Pakoja e fundit e ndihmës kap vlerën e 900 mijë

më sot është gjithsej 5 190 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 815", është thënë në njoftimin e institutit. Rastet pozitive janë nga: komuna e

eurove dhe përmban 30 ventilatorë, 200 puls-oksimetër e 20 makina elektrokardiografike, të cilat i ka dorëzuar zëvendësambasadori i BE-së në Kosovë, Riccardo Serri. Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, duke e falënderuar Bashkimin Evropian për mbështetjen e vazhdueshme, sidomos në kohën e pandemisë, ka deklaruar se pajisjet e ardhura do t'i japin shtytje riorganizimit, që ka nisur brenda institucioneve shëndetësore. "Këto pajisje do të na ndihmojnë shumë në riorganizimin që po e bëjmë bashkë me ShSKUK-në për t'i ndihmuar qytetarët, të cilët po përballen me pandeminë Covid-19", ka deklaruar Zemaj.

Edhe ushtruesi i detyrës së drejtorit të ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, e ka vlerësuar lart kontributin e Bashkimit Evropian për Kosovën në luftën me pandeminë Covid-19. "Në emër të ShSKUK-së dhe profesionistëve shëndetësorë, ju falënderojmë për ndihmën e vazhdueshme që i keni dhënë Kosovës. Bashkimi Evropian e ka ndihmuar Kosovën jo vetëm me pajisje, por edhe në forma të tjera. Kërkoj sërish që të respektohen masat dhe rekomandimet e institucioneve, në mënyrë që sa më pak të përdoren këto mjete", ka deklaruar Krasniqi.

Zëvendës-kryeministri Selmanaj del pozitiv në testin për Covid

Zëvendëskryeministri i Kosovës nga radhët e LDK-së, Driton Selmanaj, ka bërë me dije se ka dalë pozitiv në testin për Covid-19. Selmanaj ka thënë se të gjitha obligimet qeveritare do t'i kryejë nga shtëpia. "Të nderuar, dje e kam bërë testin për Covid-19 dhe sot më njoftuan që kam rezultuar pozitiv. Specialistët shëndetësorë po më thonë se jam asimptomatik. Nga momenti i testimit jam izoluar dhe kështu jam i detyruar të qëndroj edhe për dy javët e ardhshme. Do të përpiqem që të gjitha obligimet e punës t'i kryej nga shtëpia", ka shkruar Selmanaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Muhamet KOCI

EPOKA ERE

PRISHTINË, 4 GUSHT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë shëruar 201 persona nga Covid-19 dhe janë paraqitur 225 raste të reja. Në njoftimin për media, instituti ka treguar se në 24 orët e fundit kanë ndërruar jetë 13 persona të prekur nga Covid-19. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 477 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren prej të cilëve rezultojnë 225 raste pozitive. Numri total i rasteve pozitive është 9 274 raste nga 38 342 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2, me gjithsej 269 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 201 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri

Inspektorateve u zgjatet orari i punës

Asociacioni i Komunave të Kosovës ka njoftuar se inspektoratet e komunave janë duke punuar me orar të zgjatur me qëllim të zbatimit të masave anti-Covid-19. Sipas njoftimit, në shumicën e komunave janë duke u zhvilluar aktivitete të shtuara të inspektiveve që nga hyrja në fuqi të masave të reja nga Qeveria e Kosovës në luftimin e pandemisë së krijuar nga Covid 19. Asociacioni ka bërë me dije se janë shtuar aktivitetet sidomos në fushën e gastronomisë, ku komunat kanë kërkuar nga këto

subjekte që të bëhet rregullimi i hapësirave të tyre për shërbim sipas masave të parapara në mënyrë që klientët të kenë distancën e kërkuar. "Gjithashtu së bashku edhe në koordinim me Policinë është kërkuar respektimi i orarit kohor të lejuar për veprimtari të këtyre subjekteve. Aktivitetet i vazhdueshëm është duke u zhvilluar me kërkesa drejtuar qytetarëve që t'i bartin maskat gjatë gjithë kohës sipas masave të parapara. Inspektoratet komunale janë duke punuar me orar të zgjatur në të gjitha

komunat e Kosovës me qëllim të zbatimit të masave për të luftuar me situatën e krijuar si pasojë e pandemisë Covid-19", është thënë në njoftim. Ndërsa Policia e Kosovës ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit 58 persona nuk kanë respektuar masat e vendosura nga qeveria, që kanë për qëllim frenimin e përhapjes së mëtejme të koronavirusit. Rastet e mosrespektimit të masave, sipas raportit 24-orësh të policisë, kanë ndodhur në Podujevë, Ferizaj, Prizren, Malishevë dhe Vushtrri.

Flet për "Epokën e re", Shkëlzen Maliqi

Qeveria Hoti për

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka bërë me dije se qeveria Hoti gjendet në një pozitë të vështirë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se kur procesit të dialogut me Serbinë i shtohet edhe kriza e pandemisë, pozita e qeverisë Hoti është e pashpresë përballë një "cunami" shkatërrues multidimensional. Ai ka vlerësuar se nga ky "cunami" nuk do të mund të shpëtojnë as kritikuesit e kësaj qeverie. Sipas Maliqit, spektri politik duhet të heqë dorë nga interesat e ngushta dhe të unifikohet për t'u ballafaquar me sfidat të cilat e presin Kosovën

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 4 GUSHT - Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka deklaruar se qeveria Hoti gjendet përballë një cunami shkatërrues multidimensional. Ai ka thënë se kur merren parasysh rrethanat e dialogut me Serbinë dhe problemet e mëdha që po i sjell pandemia, pozita e kësaj qeverie është e pashpresë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se është e vështirë të bëhet një vlerësim objektiv i punës së deritashme të qeverisë Hoti. "Kur i shtohen kësaj edhe kriza me pandeminë, që në ndërkohë u bë galopante, nga njëra anë, si dhe kërcënimet serioz të kolapsit ekonomik të vendit, nga ana tjetër, duket sikur pozita e qeverisë Hoti është e pashpresë, që qëndron si një digë e papërfillshme përballë cunamit shkatërrues multidimensional", ka thënë

Maliqi.

Ai ka vlerësuar se nga ky cunami nuk do të mund të shpëtojnë as kritikuesit e kësaj qeverie.

Maliqi ka deklaruar se spektri politik do të duhet të unifikohet për t'i përballur sfidat me të cilat po përballlet Kosova. "Në këtë vështrim, e tërë balta e kritikave mund t'i hidhet Avdullah Hotit, por në të vërtetë cunami në fjalë do t'i godasë të gjithë pjesëmarrësit e historisë dhe histerisë që po i përjetojmë në muajt dhe vitet e fundit. Mjerimin e kësaj situatë e shohim në sjelljen e deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe të partive politike që nuk po mund t'i tejkalojnë interesat partikulare, hatërmbetjet, inatet etj. çka pamundëson mobilizimin e domosdoshëm të të gjithëve në mbrojtjen nga rreziqet që na kanosin", ka deklaruar ai. Sipas Maliqit, në këtë situatë lideri i LV-së, Albin Kurti, po luan me një kartë të rrezikshme. "Askush nuk po më duket i sqartë në

deklaratat dhe performancat. Për më shumë, edhe rreshtimet janë të çuditshme, me paranteza. Nëse e shkoni mirë, edhe koalicioni i brishtë qeveritar, edhe opozita po veprojnë si me mekanizma të kontrollit të marionetave", ka

deklaruar Maliqi.

"Epoka e re": Z. Maliqi, cili është vlerësimi juaj për punën e deritashme të qeverisë Hoti?
Maliqi: Është i vështirë vlerësimi objektiv i punës së qeverisë Hoti jo vetëm pse

është në fillimet (zakonisht qeverive i jepet afat i arsyeshëm që t'i tregojnë aftësitë dhe performancën e tyre), e në këtë rast duhet të kihen parasysh edhe rrethanat e jashtme relevante për vlerësim, që kanë qenë

Hyseni paralajmëron angazhim amerikan në dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 4 GUSHT - Koordinator i Shtetëror i Kosovës në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Skender Hyseni, ka thënë për "Zërin e Amerikës" se Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të kenë përkushtim të paluhatshtëm për dialogun që zhvillohet mes këtyre dy shteteve në Bruksel nga viti 2011. Këto komente ai i ka bërë pas takimit të zhvilluar me të dërguarin e Departamentit Amerikan të Shtetit për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer, në Uashington. "Ka një përkushtim të paluhatshtëm në përkrahje të dialogut të filluar në Bruksel dhe një përkrahje të fuqishme për një marrëveshje gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe

të qëndrueshme, sa i përket normalizimit të raporteve midis Kosovës dhe Serbisë", ka deklaruar Hyseni. Sipas tij, dialogu mes të dyja shteteve duhet të finalizohet me njohje reciproke. "Ne po punojmë ngushtë me ShBA-në që procesi i normalizimit të ecë shpejt deri në njohje të plotë reciproke si dy shtete të pavarura dhe sovranë", ka thënë Hyseni.

Madje Hyseni ka përmendur edhe mundësinë e përfshirjes së ShBA-së në dialog. "Do të shohim hapa konkretë të kyçjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në dialog krahas Bashkimit Evropian", është shprehur ai.

Sa iu përket dilemave rreth zhvillimit të dialogut në nivel

teknik, koordinatori shtetëror i Kosovës ka thënë se "nuk ka asgjë teknike deri në përmblyllje të njohjes reciproke". "Çdo gjë është skajshëm politike. Çdo gjë bart një dimension politik akut dhe ai dimension politik akut duhet të adresohet dhe të zgjidhet ekskluzivisht në një marrëveshje gjithëpërfshirëse, që nënkupton njohje të ndërsjellë mes këtyre vendeve", ka deklaruar ai.

Hyseni është nisur më 1 gusht në Uashington, pas bisedimeve të zhvilluara në nivel ekspertësh me palën serbe në Bruksel. Serbia në këtë proces është përfaqësuar nga drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq. Temë e diskutimit është thënë të kenë qenë të



zhvendosurit dhe bashkëpunimi rajonal.

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë ka rinisur më 16 korrik të këtij viti. Ky proces ishte pezulluar nga nëntori i vitit 2018 me që autoritetet e

Kosovës patën vënë taksë në importet e Serbisë. Kjo masë ka qenë e papranueshme për autoritetet serbe, kurse heqjen e saj më vonë e ka mirëpritur edhe faktori ndërkombëtar me qëllim të rikthimit të dialogut.

ballë 'cunamit'

administratës amerikane, që edhe çoi në largimin e qeverisë Kurti, e që tani, kur qeveria Hoti korrigjoi lëshimin dhe e hapi dialogun, jemi dëshmitarë se momentumi premtues i tij duket i ikur dhe se jemi kthyer në binaret që ky dialogu pat mbetur i bllokuar më parë. Kur i shtohet kësaj edhe kriza me pandeminë, që në ndërkohë u bë galopante, nga njëra anë, si dhe kërcënimi serioz i kolapsit ekonomik të vendit, nga ana tjetër, duket sikur pozita e qeverisë Hoti është e pashpresë, që qëndron si një digë e papërfillshme përballë cunamit shkatërrues multidimensional. Në këtë vështrim, e tërë balta e kritikave mund t'i hidhet Avdullah Hotit por, në të vërtetë, cunami në fjalë do t'i godasë të gjithë pjesëmarrësit e historisë dhe histerisë që po i përjetojmë në muajt dhe vitet e fundit. Mjerimin e kësaj situatë e shohim në sjelljen e deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe të partive politike që nuk po mund t'i tejkalojnë interesat partikulare, hatërmbetjet, inatet etj. çka pamundëson mobilizimin e domosdoshëm të të gjithëve në mbrojtjen nga rreziqet që na kanosin. Kryeministri Hoti edhe kur përpiqet s'po arrin t'i bashkojë forcat, e as të tjerët nuk kanë gjasa ta bëjnë këtë. Ndërkaq, Albin Kurti po luan me një kartë të rrezikshme të fitores së shumicës absolute në zgjedhjet e ardhshme.

"Epoka e re": Kritikkat ndaj kësaj qeverie janë shtuar edhe nga partnerët e koalicionit,

sidomos për qasjen e kryeministrit Hoti ndaj dialogut Kosovë - Serbi dhe menaxhimin e pandemisë. Si i keni parë këto kritika?

Maliqi: Më duken si pjesë e mjerimit të politikës tonë që e përshkrova më parë. Qeveria edhe është krijuar gati me paterica, mezi mbahet në këmbë, e tash edhe përbrenda duan t'ia zënë hapin. Kritikuesit sikur ia kanë frikën dështimit të dialogut dhe luftës me pandeminë, kështu që duan ta sigurojnë një distancë të një fushate parazgjedhore. Askush nuk po më duket i sqarë në deklarata dhe performanca. Për më shumë, edhe rreshtimet janë të çuditshme, me paranteza. Nëse e shkon mirë, edhe koalicioni i brishtë qeveritar, edhe opozita po veprojnë si me mekanizma të kontrollit të marionetave. Vendimmarrësit dhe mujshtarët e politikës së Kosovës janë tërhequr në prapavijë nga ku komandojnë proceset, kurse përpara i shtojnë vartësit në kacafytje me problemet dhe dubiozat e proceseve. Kjo sidomos vlen për dialogun që ende nuk dihet a është ai i synuar, i përfundimit me njohje të ndërsjellë.

"Epoka e re": Siç po shihet deri më tani, edhe kjo qeveri do të merret intensivisht me dialogun me Serbinë. Kryeministri ka thënë se ka filluar draftimi i marrëveshjes përfundimtare me Serbinë. A ka kapacitete që kjo qeveri ta

mbyllë këtë proces?

Maliqi: Ka dyshime në kapacitetet e qeverisë për ta arritur marrëveshjen finale, por edhe për rrethanat ndërkombëtare që ajo të arrihet. Shkuarja e Skender Hysenit në Uashington ndoshta do t'i sqarojë gjërat dhe ul nervozen, të sqarohemi se e jemi në pikën kritike të marrëveshjes finale, apo të jemi realistë rreth një procesi më afatgjatë. Draftimi i marrëveshjes është proces normal i fillimit të të gjitha marrëveshjeve të rëndësishme. Dhe, një të tillë ka mundur të ketë edhe në takimin e fundit në Bruksel, por ato janë matje e pulsit të të dyja palëve sa janë të gatshme për kompromise eventuale.

"Epoka e re": Në këtë fazë nuk kemi parë ndonjë pjesëmarrje shumë aktive të ShBA-së në dialogun e Brukselit. Pritni ndonjë përfshirje më të madhe të ShBA-së në vazhdim të këtij procesi?

Maliqi: Mendoj se pas buldozer-demokracisë në tentim të Riçard Grenellit tani kemi hyrë në një fazë ku ShBA-ja do të jetë aktive, por si faktor i distancuar, jo direkt i negociatave. Në të vërtetë edhe Granelli pat thënë, pasi që dështoi samiti i Uashingtonit më 27 qershor, se ShBA-ja synon ta mbajë tryezën e negociatave ekonomike, kurse ato politike i takojnë BE-së, meqë Kosova dhe Serbia synojnë integrimin në BE. Kjo strategji nuk është e rastësishme, por e

menduar ta eliminojë futjen e Rusisë në negociatë. Nëse ShBA-ja do të ishte pjesë e tryezës me BE-në, Serbia do ta kërkonte praninë e Rusisë, siç ka qenë formula e tryezave të mëhershme. Besoj se ShBA-ja me Rusinë do të bisedojë në nivele të tjera, kurse me BE-në do të provohet arritja e marrëveshjes finale në mes të Kosovës dhe Serbisë, gjithnjë e mbikëqyruar nga ShBA-ja.

"Epoka e re": Për çdo votim të rëndësishëm në Kuvend, koalicionit qeverisës po i duhen votat e opozitës. Sa mendoni se mund të zgjasë kjo qeveri, apo pritni një zgjerim të këtij koalicioni?

Maliqi: Mendoj se në ndonjë moment kritik, nëse qeverisë i duhen numrat kundër mocionit potencial të mosbesimit, PDK-ja mund ta mbajë qeverinë Hoti në pushtet nëse negociatat me Serbinë zhvillohen me kahe pozitive ose premtuese. Po kështu, PDK-ja si parti me rolin kingmaker do të kujdeset që vendi të mos shkojë në zgjedhje të parakohshme kur kjo nuk i konvenon asaj dhe partive të tjera në qeveri, pos në rast se, në ndërkohë, nuk ndodh avancim në raportet mes PDK-së dhe LV-së, të paktën heqjes së vijës së kuqe të bashkëpunimit eventual. Por, nuk po shoh se ka shenja të tilla përderisa LV-ja ushqen bindjen e fitores së madhe ndaj "politikës së vjetër", ku i fut të gjitha partitë, pos veten.



shkaktare të krijimit me nguti të saj, por që tani edhe ato rrethana shihen me skepticizëm. E kam fjalën, p. sh., për motivin kryesor të ngutisë, nevojën për vazhdimin e dialogut me Serbinë, si prioritet i

Projektligji për UÇK-në dhe ai për pandeminë pritet të votohen të premtën në Kuvend

PRISHTINË, 4 GUSHT (ER) - Të premtën në orën 10:30 Kuvendi i Republikës së Kosovës do t'i vazhdojë punimet me pikat e mbetura nga seancat e kaluara, përkatësisht votimin e propozim-rezolutave dhe rekomandimeve, ndërsa në orën 11:00 do të mblidhet në seancë të re. Kështu ka vendosur të martën kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur në mënyrë elektronike (virtuale), nën drejtimin e kryetares Vjosa Osmani dhe pjesëmarrje të kryetarëve të grupeve parlamentare. Seanca e re do të fillojë me pikat e zakonshme, deklarime jashtë rendit të ditës dhe pyetje parlamentare, ndërsa

më pas pritet të bëhet shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës dhe shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së. Seanca do të vazhdojë me zgjedhjen e dy anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, zgjedhjen e një anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e fakulteteve juridike të Republikës së Kosovës, zgjedhjen e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, si dhe shqyrtimin e propozim-vendimit për caktimin e pagës së drejtorit dhe

zëvendës drejtorit të sekretariatit ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. Po ashtu, deputetët pritet ta shqyrtojnë edhe kërkesën e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë për miratimin e buxhetit të këtij komisioni si dhe atë të grupit parlamentar të Vetëvendosjes për zëvendësimin e anëtarëve në komisione parlamentare. Në mbledhjen e së martës, kryesia ka vendosur ta procedojë për mendim në qeveri Projektligjin për ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete, i hartuar nga grupi parlamentar i Vetëvendosjes.



Veliu vlerëson lart punën e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë

PRISHTINË, 4 GUSHT (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Agim Veliu, ka vizituar të martën Agjencinë e Kosovës për Forenzikë (AKF). Veliu në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se gjatë kësaj vizite i ka ofruar mbështetje të plotë kësaj

agjencie. Në këtë kontekst, ai ka thënë se u është mirënjohjes partnerëve ndërkombëtarë për ngritjen dhe avancimin e AFK-së. "Me këtë rast vlerësova punën që po bën kjo agjenci dhe ofrova mbështetje për nevojat specifike, sidomos në

akreditime ndërkombëtare të laboratorëve dhe mirëmbajtjen e sistemeve nacionale. U jemi mirënjohës partnerëve ndërkombëtarë, në veçanti ShBA-së, për ndihmën e dhënë në ngjitjen dhe avancimin e kësaj agjencie", ka shkruar Veliu.



Licencimi i çerdheve private, kompetencë e Ministrisë së Arsimit

PRISHTINË, 4 GUSHT (ER) - Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) ka sqaruar opinionin publik se licencimi i Institucioneve Edukativo-Arsimore Parashkollore Private është kompetencë e kësaj ministrie. Përmes një njoftimi për media, MASH-i ka treguar se procedurat e licencimit të këtyre institucioneve kërkojnë edhe pjesëmarrjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe komunave përkatëse. "MASH-i sqaron se licencimi i Institucioneve Edukativo-Arsimore Parashkollore Private (IEAPP) është kompetencë e saj. Megjithatë, procedura e licencimit ngërthen në vete disa faza, të cilat, përveç MASH, kërkojnë edhe pjesëmarrjen e disa institucioneve publike, si Ministria e Punëve të

Brendshme dhe komuna përkatëse. Bazuar në legjislacionin në fuqi, procedurat për licencim janë të ndërlidhura edhe me dhënien e pëlqimit të institucioneve të tjera publike, nga pëlqimi i të cilave varet pajisja me licencë IEAPP-ve nga ana e MASH", është thënë në njoftimin e MASH-it. Sipas njoftimit, kjo nënkupton se nëse institucioni përkatës kompetent nuk e jep pëlqimin për plotësimin e kushteve higjienike-sanitare dhe pëlqimin për sigurim nga zjarri, IEAPP-të nuk mund t'u nënshtrohen tutje procedurave të licencimit.

"Për më tepër, edhe në situatat kur IEAPP-të janë të pajisura me licencë nga MASH, të njëjtat mund të mbyllën nga Inspektorati Sanitar i komunës




përkatëse kur konstatohet se IEAPP nuk u është përmbajtur rregullave të lëshuara nga ana e tyre. Marrë parasysh situatën e krijuar me Covid-19, të gjitha institucionet publike (përgjegjëse) duhet të kontribuojnë në luftimin e

pandemisë që ndërlidhet pikërisht me përmbushjen e kushteve higjienike-sanitare", është thënë në njoftim. MASH-i ka bërë me dije se është kompetencë e autoriteteve komunale, sipas nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.

15/2016, që ta lëshojnë vërtetimin mbi plotësimin e kushteve higjienike-sanitare të çerdheve. "Për deklarimin publik ku thuhet se nuk është kompetencë e komunave t'i mbikëqyrë dhe kontrollojë kopshtet private si dhe komuna nuk ka listë të IEAPP-ve, MASH njofton se lista e të gjitha IEAPP-ve të licencuara publikohet në faqen zyrtare të MASH dhe e njëjta është e qasshme për publikun dhe palët e interesuara. Do të jemi në kontakt që vazhdueshëm me DKA-të që bashkë ta analizojmë gjendjen e IEAPP-ve dhe të pajtohemi për t'i zbatuar edhe më tej detyrimet që dalin nga legjislacioni në fuqi" është thënë në njoftimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH).

Osmani: Mbrojtja e mjedisit, e drejtë kushtetuese e qytetarëve të Kosovës

Prishtinë, 4 gusht (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka mbajtur të martën një takim online me përfaqësuesen e organizatës joqeveritare OJQ "Pishtarët", Shpresa Loshaj, me të cilën ka diskutuar në lidhje me çështjen e degradimit të mjedisit në vendin tonë si rezultat i ndërtimit të hidrocentraleve me kapacitet të vogël gjenerues, ku në veçanti është trajtuar rasti i tri hidrocentraleve të ndërtuara në Komunën e Deçanit. Fillimisht, Osmani e ka përgëzuar Loshajn dhe aktivistët ambientalistë për punën që po bëjnë për ngritjen e vetëdijes qytetare për



rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit. "Degradimi i mjedisit në emër të promovimit të investimeve në burime të ripërtërishme të energjisë është i papranueshëm. Ekzistojnë mënyra të duhura se si këto

investime mund të realizohen me sukses, e kjo bëhet gjithmonë në konsultim të ngushtë me qytetarët e Kosovës", ka thënë kryetarja Osmani. Ajo ka thënë se, përveç

kompanive investuese, përgjegjësia bie tek institucionet vendore dhe të dyja palët duhet të sigurohen që investimet të bëhen konform ligjeve, e jo konform interesave të një grupi të vogël të interesit. Në këtë takim, Loshaj e ka ndritur edhe çështjen e padive dhe kërcënimeve që po i bëhen asaj dhe aktivistëve nga kompania investuese në Komunën e Deçanit.

Lidhur me këtë, Osmani ka theksuar se liria e shprehjes nuk guxon të kërcënohet nga askush dhe se ngritja e një padie strategjike kundër pjesëmarrjes së publikut (SLAPP) ndaj njërit prej aktivistëve, me qëllimin të

heshtë dhe frikësorë kritikët, duke i ngarkuar ata me kosto të lartë të mbrojtjes ligjore në mënyrë që ta braktisin kundërshtimin e tyre, është pikërisht një kanosje e drejtpërdrejt ndaj lirisë së shprehjes. "Do të angazhohem personalisht ta ngrah vetëdijen rreth rëndësisë së mbrojtjes së mjedisit dhe lirisë së shprehjes. Gjersa, përmes një komisioni hetimor parlamentar do të angazhohemi që ta trajtojmë përmbajtësisht dhe ta sqarojmë përfundimisht aspektin ligjor të këtyre hidrocentraleve. Shpresojmë që edhe qeveria do ta ndjekë të njëjtin shembull", është shprehur Osmani.



Hoxhaj: Serbia po armatohet nga Kina, BE-ja ende asnjë fjalë

PRISHTINË, 4 GUSHT (ER) - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, ka deklaruar se Bashkimi Evropian nuk ka thënë asnjë fjalë për raketat që Serbia i bleu së fundmi nga Kina. Në llogarinë e vet në "Twitter", ai ka shkruar se Serbia

është shteti i parë evropian që blen raketa nga Kina, duke shtuar se ky armatim ka implikime për paqe dhe siguri në Ballkan. "Serbia është shteti i parë evropian që blen raketa që mund të godasin nga sipërfaqja e tokës në ajër, nga Kina, në

armatim të vazhdueshëm nga Rusia dhe Kina. Akoma asnjë reagim nga Bashkimi Evropian, Ursula von der Leyen dhe Josef Borell për këtë manovër nga Aleksandar Vuçiqi që ka implikime për paqe dhe siguri në Ballkan", ka shkruar Hoxhaj.

Buxheti, kusht për ngritjen e kapaciteteve të FSK-së

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka në dispozicion 68 automjete ushtarake të tipit "Humvee" të cilat janë prodhim amerikan. Komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Rrahman Rama, ka bërë me dije se vitin e ardhshëm kjo forcë do të pajisjet me automjete të ngjashme, por më të mëdha. Rama ka thënë se të gjitha kontratat për blerje të sistemit të armatimit dhe automjeteve taktike, FSK-ja do t'i ketë me ShBA-në. Në këtë kontekst, ai ka thënë se në të ardhmen FSK-ja pritet të ketë edhe helikopterë e pajisje të tjera ushtarake, por një gjë e tillë, sipas tij, do të varet nga buxheti



Ibrahim Berisha (RFE/RL)

PRISHTINE, 4 GUSHT - Me arritjen e kontingjentit të fundit të automjeteve ushtarake taktike të tipit "Humvee" nga ShBA-ja, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) tashmë është bërë me 68 të tilla, ku 27 kanë qenë donacion, kurse pjesa tjetër është blerë nga buxheti i Kosovës, ka bërë me dije për "Radion Evropa e Lirë", komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Rrahman Rama. Sipas tij, FSK-ja deri tani ka afërsisht 30 për qind të mjeteve taktike të cilat i nevojiten. "Janë këto pajisje që ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve të reja që i kemi mbi bazën e mandatit dhe misionit", ka thënë Rama.

Ai ka thënë se vitin e ardhshëm FSK-ja do të pajisjet me automjete të ngjashme, por më të mëdha, të tipit "Humvee". Vlera e kontratave të këtyre porosive tash për tash është konfidenciale. "Në të ardhmen normalisht do të publikohet edhe kontrata edhe çmimi i tyre. Është një çmim real, një çmim i përshtatshëm dhe neve na ka hyrë në funksion", ka thënë Rama.

Që nga ndryshimet ligjore më 2018, Forca e Sigurisë së Kosovës është pajisur me mjete të ndryshme. Sa i përket armatimit, disa nga to që FSK-ja ka në dispozicion janë pushkë amerikane të tipit "M4 carbine", ato gjermane "Heckler&Koch" 5/56 dhe 9 mm etj. Në të ardhmen kjo forcë pritet të ketë edhe helikopterë e pajisje të tjera, ka thënë gjeneralletjënant Rama por, sipas tij, kjo do të varet nga buxheti. "Jemi në proces që ta rrisim këtë numër të armatimit dhe kalibrave të ndryshëm. Për helikopterë kemi plan, por tash varet nga mundësitë buxhetore. Megjithatë, e kemi idenë e qartë dhe jemi në proces e sipër. E kemi ndërtuar një plan të

përbashkët me partnerët tanë strategjikë. Fillimisht do t'i kemi katër e pastaj shohim në të ardhmen. Por, krejt kjo varet nga mundësitë buxhetore", ka thënë Rama.

Më tutje, Rama ka thënë se të gjitha kontratat për blerje të sistemit të armatimit dhe automjeteve taktike, FSK-ja do t'i ketë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në dhjetor të vitit 2018, Kuvendi i Kosovës ka miratuar ndryshimet ligjore për ta ndryshuar mandatin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Kësaj force është thënë se do t'i nevojitet një periudhë kohore prej 10 vjetësh për t'u transformuar në ushtri me kapacitete të plota. Kapacitet e plota operacionale parashihen që të arrihen në fazën e tretë.

Përgjegjësitë e reja të FSK-së kanë të bëjnë me ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial, qytetarëve, pronave dhe interesave të Republikës së Kosovës, si dhe mbështetje ushtarake për autoritetet civile dhe pjesëmarrjen në operacionet ndërkombëtare.

Më herët është thënë se transformimi dhe ngritja e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës pritet t'i kushtojë buxhetit të Kosovës nga 55 milionë euro në vit, sa ka qenë në vitin 2018, në afër 100 milionë euro në vit, diku pas 5 apo 6 vjetësh. Për transformimin e FSK-së është planifikuar që buxheti për çdo vit të rritet me nga 5.5 milionë euro që, deri më tani, sipas Ramës, kjo gjë është përkrahur. Autoritetet në Kosovë tash e dy vjet po e zbatojnë fazën e parë të transformimit të FSK-së në ushtri dhe zyrtarët theksojnë se FSK-ja është në rrugë të drejtë për t'u bërë ushtri, që do ta mbrojë sovranitetin dhe integritetin e vendit.

Komandanti i FSK-së, Rrahman

Rama, ka thënë se shumë shpejt kjo forcë do ta ketë strategjinë e miratuar të mbrojtjes, e cila po hartohet me partnerët ndërkombëtarë. Sipas tij, për këtë është punuar ngushtë me ekspertët nga ShBA-ja, por edhe nga Britania e Madhe si dhe për hartimin e kësaj strategjie kanë marrë pjesë edhe institucionet relevante të Kosovës.

Ndërsa ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, ka thënë se në rrafshin e trajnimeve e të mbështetjes në fushën e mbrojtjes, ka rreth 14 marrëveshje me shtete të ndryshme. Sipas tij, mbështetja kryesore për FSK-në vjen nga ShBA-ja, Republika Federale e Gjermanisë, Turqia, Kroacia, Britania e Madhe, Shqipëria e të tjera. Në kuadër të mekanizmave të NATO-s, në Kosovë ushtron detyrat e tij edhe ekipi këshillues ndërlidhës i quajtur NALT, nën udhëheqjen e një oficeri në rang.

Quni ka thënë se gjatë këtij viti në procedurë do të jenë edhe disa ligje të cilat do t'i kontribuojnë avancimit të mëtejshëm të FSK-së. "Në proces për vitin 2020 është Ligji për zbarkim i FSK-së në operacione ndërkombëtare dhe një numër rregulloresh të cilat përcaktojnë dhe rregullojnë bazën ligjore të FSK-së. Kërkesat për legjislacion për të ardhmen janë Ligji për policinë ushtarake, Ligji për inteligjencën ushtarake, Ligji për kibernetikën shtetërore, ai për prokurimet e mbrojtjes, për autoritetet në gjendje të jashtëzakonshme e gjendje luftime të tjera", ka thënë Quni. Komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Rrahman Rama, ka thënë se synimi i FSK-së është anëtarësimi në NATO. Sipas tij, FSK-ja ka një bashkëpunim të mirë me

NATO-n dhe se vazhdimisht nga NATO-ja dërgohen këshilltarë të ndryshëm për ta ndihmuar FSK-në për ngritjen e kapaciteteve. "Ne kemi një ekip prej 24 këshilluesve që vijnë nga shtetet e ndryshme që janë pjesë e jona dhe për çdo ditë ne bashkëpunojmë, koordinohemi e na këshillojnë për ngritjen e kapaciteteve tona të reja", ka thënë Rama.

Ndërsa ish-komandanti i Forcave të Sigurisë së Kosovës, Kadri Kastrati, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se beson që procesi i transformimit të FSK-së duhet të përfundojë në periudhë prej 6 deri në 8 vjet. Ai ka thënë se FSK-ja në të ardhmen do të jetë një forcë e fuqishme ushtarake, që do të jetë e aftë t'i kryejë të gjitha detyrimet që dalin nga misioni dhe ligjet për forcën ushtarake të Kosovës. "Çka do të thotë kjo? Që do të jetë e aftë që ta mbrojë territorin e Kosovës, integritetin dhe sovranitetin e vendit, t'i mbështesë autoritetet civile, ta mbrojë jetën dhe pasurinë e qytetarëve dhe të jetë e aftë për të marrë pjesë në operacione paqeruajtëse dhe operacione të tjera humanitare në kuadër të NATO-s, Bashkimit Evropian dhe Kombeve të Bashkuara", ka thënë Kastrati. Ai ka thënë se transformimin e FSK-së është e rëndësishme që po e mbështet ShBA-ja, por edhe shtetet e tjera evropiane.

Ndërsa njohësja e çështjeve të sigurisë, Besa Kabashi-Ramaj, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se sektori i sigurisë në Kosovë asnjëherë nuk e ka zënë vendin e duhur në nivelin kombëtar. Ajo ka theksuar se FSK-ja në mënyrë vetjake nuk mund t'i arrijë të gjitha kapacitetet nëse nuk ndihmohet edhe nga faktorë të tjerë. "Nëse niveli qendror nuk investon sa duhet në sektorin e

sigurisë, kapacitetet e tilla nuk mund të ndërtohen aq shpejt. Njëkohësisht nevojitet edhe harmonizim i institucioneve të tjera. Edhe po t'i krijojë FSK-ja të gjitha kapacitetet e veta, ne duhet ta kemi të qartë që mbrojtja e Republikës së Kosovës dhe integriteti territorial i saj nuk varen vetëm nga forcat e armatosura, por varet edhe nga marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe sidomos nga marrëdhëniet strategjike që i ka Kosova me partnerët e saj strategjikë", ka thënë Kabashi-Ramaj, duke shtuar se investimet në sigurinë e Kosovës duhet të jenë më të mëdha. "Edhe investimi karshi sektorit të sigurisë duhet të jenë më serioz, këtu përfshihet natyrisht edhe FSK-ja. Pra, nëse po ndërtojmë një ushtri të mirëfilltë, atëherë duhet të sigurohemi që të gjitha kapacitetet që i ka të përmbushen", është shprehur Kabashi-Ramaj.

Forca e Sigurisë së Kosovës u themelua më 2009 në bazë të Planit të Ahtisaarit, dokument që çoi drejt pavarësisht të Kosovës. Kjo Forcë është ngritur nën mbikëqyrjen e NATO-s, por misioni dhe kapacitetet e saj nuk përkuan me ambicien e institucioneve, që Kosova ta ketë Ushtrinë e saj. Pas përfundimit të konfliktit të armatosur të vitit 1999, në marrëveshje me NATO-n, ishin formuar Trupat Mbrojtëse të Kosovës si forcë për emergjencë. Kjo Trupë më pas ishte shndërruar në Forcën e Sigurisë së Kosovës. FSK-ja aktualisht numëron 2 500 pjesëtarë të rregullt dhe 800 rezervistë. Ky numër, pas ndërrimit të mandatit, do të dyfishohet. Me mandatin e ri parashihet që të ketë 5 000 ushtarë aktivë dhe 3 000 pjesëtarë rezervë.

Rriten çmimet e prodhimeve blegtorale dhe bimore në Kosovë

Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) në tremujorin e dytë të këtij viti ka bërë me dije se indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka shënuar rritje me 7.89 për qind. Po ashtu, ASK-ja ka bërë me dije se edhe indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka shënuar rritje 7.25 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak

**EPOKA E RE**

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 GUSHT - Në tremujorin e dytë të vitit 2020 indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka shënuar rritje 7.89 për qind. Edhe indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka shënuar rritje me 7.25 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Kështu është thënë në raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Në raportin më të ri të ASK-së për "Indeksin e Çmimeve të

Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi" për tremujorin e dytë 2020 është thënë se "indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore ka rritje për 7.69 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019". Sipas ASK-së, ky publikim është i bazuar në grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore vendore në Kosovë. Grumbullimi i të dhënave, siç ka njoftuar ASK-ja, është bërë në treg, ferma dhe vende të tjera, ku çmimet e prodhimeve bujqësore mund të grumbullohen. "Prodhimet që krijojnë

bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Në kuadër të prodhimeve bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë.

Në prodhimet blegtorale çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe prodhimet blegtorale. Në kuadër të blegtorisë, çmimet grumbullohen për katër kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derra dhe pula. Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kafshëve",

është thënë në raportin e ASK-së, duke u shtuar se në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjaltë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në euro dhe njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë.

Hoxha: As qeveria Kurti e as Hoti nuk arritën ta ndihmojnë sektorin privat



PRISHTINË, 4 GUSHT (ER) - Deputeti i PDK-së ka reaguar lidhur me vonesat për zbatimin e pakos emergjente, rrjedhimisht për vonesën në ndihmë të sektorit privat. Hoxha ka thënë se është i turpshëm dhe i patolerueshëm dështimi i dy qeverive, asaj Kurti dhe kësaj Hoti, që për më shumë se gjashtë muaj nuk kanë arritur që përmes buxhetit të shtetit ta implementojnë një pako të vetme fiskale, e cila i ndihmon bizneset dhe qytetarët të cilët janë prekur nga pandemia. "Kosova është vendi më i vonuar për t'i ndihmuar bizneset dhe qytetarët nga pandemia. Është i turpshëm dhe i patolerueshëm dështimi i dy qeverive, asaj Kurti dhe kësaj Hoti, që për më shumë se gjashtë muaj nuk arritën që përmes buxhetit të

shtetit ta implementojnë një pako të vetme fiskale e cila i ndihmon bizneset dhe qytetarët të cilët janë prekur nga pandemia. Nuk ekzekutuan as 170 eurot e premtuara, as pagesat e qeras së bizneseve. Filluan të marrin edhe vendime të cilat i pengojnë bizneset siç është rasti me kufizimin e orarit të punës për sektorin e gastronomisë i cili është punëdhënësi më i madh në sektorin privat, e pas pak ditësh e vërejtën që bënë gabim të radhës dhe u munduan ta përmirësojnë. Sinqerisht këto janë veprime amatore të cilat nuk guxon t'i bëjë një qeveri e një vendi normal", ka shkruar Hoxha në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se PDK-ja për shkak të situatës së rënduar nga Covid-19 e ka votuar rishikimin e buxhetit.

Qytetarët e Kosovës u mashtruan për sasinë e djathit të prodhuar në Maqedoninë e Veriut

PRISHTINË, 4 GUSHT - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) ka njoftuar se, pas marrjes së mostrave, sasitë e dy llojeve të djathit, të prodhuar në Maqedoninë Veriore, kanë rezultuar jo të sakta. "Dy lloj të djathit kanë rezultuar me sasi jo të saktë. Mostrat janë marrë në një biznes në Prishtinë gjatë vizitës së ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, në pjesën e dytë të

muajit që shkoi. Zyrtarë të MTI-së, pas ekspertizës së produkteve, kanë konstatuar se sasia e përshkruar në paketim nuk përkon me sasinë reale të produktit dhe në këtë mënyrë është mashtruar konsumatori", ka njoftuar MTI-së. Sipas këtij njoftimi, ministri Krasniqi është interesuar për cilësinë e ushqimit, në veçanti për produktet e qumështit pas

ankesave që ka marrë nga shoqata të ndryshme të kësaj fushe. "Mbështetja për biznese nuk do të mungojë, por nuk do të lejohet që të drejtat e konsumatorit të shkelen", citohet të ketë thënë Krasniqi. Ai ka potencuar se fokus kryesor i tij dhe ministrisë që drejton do të jetë mbrojtja e prodhuesve vendorë dhe ajo e konsumatorit.



Qeveria shkarkon bordet e emëruara nga Kurti, emëron të Hotit

Qeveria e Kosovës, e cila drejtohet nga Avdullah Hoti, ka marrë vendim për shkarkimin e bordeve të përkohshme të drejtorëve të katër ndërmarrjeve publike të cilat ishin emëruar nga ish-qeveria Kurti. Pas shkarkimit të bordeve, qeveria ka emëruar anëtarët e rinj në KRU "Prishtina" "Ibër-Lepenc", KEK dhe në KRU "Hidroregjioni Jugor". Ndaj këtij vendimi ka reaguar ish-ministrja Rozeta Hajdari, e cila i ka akuzuar kryeministrin Hoti dhe ministrin Blerim Kuçi se janë duke punuar në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjet në fuqi



EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 GUSHT - Qeveria e Kosovës të martën ka marrë vendim për shkarkimin e bordeve të përkohshme të drejtorëve të katër ndërmarrjeve publike, konkretisht të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit (KRU) "Prishtina", "Ibër-Lepenc", Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) dhe të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit (KRU) "Hidroregjioni Jugor" në Prizren. Shkarkimi i bordeve të këtyre ndërmarrjeve të cilat ishin emëruar nga ish-kryeministri Albin Kurti, sipas Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit të udhëhequr nga Blerim Kuçi i AAK-së, ka ardhur si pasojë e mosrespektimit të rekomandimit dhe kërkesës nga aksionarja - Qeveria e Kosovës, që ka kompetencë ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionares në ndërmarrjet publike qendrore, duke u mbështetur në Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike dhe Ligjin për Shoqëri Tregtare. "Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, e cila ka përgjegjësi të përfundimit të aksionarit në këto ndërmarrje publike, e ka brena vetes Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike. Kjo njësi i ka dërguar rekomandim dhe kërkesë ministrit Blerim Kuçi për pezullimin e procedurave të rekrutimit të pozitave të larta në ndërmarrjet publike. Arsyeya e kërkesës për pezullimin ishte që duhet pritur deri në fillimin e zbatimit të mar-

rëveshjes së nënshkruar me Ambasadën e Britanisë, për asistencë në përzgjedhje meritorë të pozitave të larta dhe udhëheqëse në ndërmarrje publike qendrore dhe agjenci qeveritare", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit (MEA).

Sipas këtij njoftimi, pasi bordet e përkohshme emërohen dhe kanë mandat të shkurtër (gjashtëmuor) e nuk përzgjidhen me konkurs, ato nuk mund t'u përshtaten objektivave afatgjatë të ndërmarrjes, duke rekrutuar pozita të rregullta afatgjata të menaxhmentit në ndërmarrjet publike ku vepronë, siç është tentuar të bëhet. "Pas këtij rekomandimi dhe kërkesë, ministri Kuçi u ka dërguar menjëherë ndërmarrjeve publike qendrore kërkesë që t'i pezullojnë përkohësisht këto procedura të rekrutimit, deri në fillim të zbatimit të marrëveshjes me Ambasadën Britanike. Kjo kërkesë e ministrit është injoruar totalisht që të zbatohet, madje jo vetëm një herë. Të katër bordet e përkohshme të ndërmarrjeve publike: Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), KRU 'Prishtinës', ndërmarrjes publike qendrore NPH 'Ibër-Lepenc' dhe KRU 'Hidroregjioni Jugor', që tashmë janë shkarkuar nga Qeveria e Kosovës, përkundër kërkesës së ministrit Blerim Kuçi kanë vazhduar procedurat e rekrutimit të zyrtarëve të lartë. Në këtë pikë, për shkak të mospezullimit të procedurave sipas kërkesës së aksionarit, ka ardhur shkarkimi i këtyre bor-

deve të përkohshme dhe zëvendësimi me anëtarë të rinj të përkohshëm të bordeve të katër ndërmarrjeve publike qendrore", ka njoftuar MEA-ja, duke u bërë thirrje të gjithë të interesuarave që të marrin pjesë në përzgjedhjen e anëtarëve të rinj të bordeve. "Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit është e përkushtuar për zbatimin e marrëveshjeve me organizatat joqeveritare dhe ambasadat, që pozitave udhëheqëse në ndërmarrje publike dhe bordet e këtyre ndërmarrjeve të jenë profesionale dhe meritorë. Ministri Blerim Kuçi fton të gjitha organizatat joqeveritare, organizatat ndërkombëtare, ambasadat dhe mediat të jenë mbikëqyrës të përzgjedhjes së bordeve të rregullta dhe pozitave drejtuese", ka njoftuar MEA-ja.

Hajdari pas shkarkimit të bordeve: Qeveria Hoti po punon për shtetin e kapur

Pas këtij veprimi të qeverisë Hoti, ka reaguar ish-ministrja e Ekonomisë, Punës, Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEP-TINIS) në qeverinë Kurti, Rozeta Hajdari, në kohën e së cilës ishin emëruar bordet e reja. Ajo ka thënë se qeveria Hoti me veprime të tilla është duke punuar për shtetin e kapur. "Katër vendimet e djeshme, ashtu si përpjekjet që

u paraprinë vendimeve, paraqesin ndërhyrje të rëndë të zotërinjve Hoti e Kuçi në punën e pavarur të bordeve. Ata kanë penguar vazhdimisht drejtorët ta kryejnë detyrën e tyre, kurse tani kanë marrë vendimet tinëzore që shkelin ligjin dhe rrezikojnë të ardhmen e ndërmarrjeve. Kushtetuta e Republikës së Kosovës thotë se ndërmarrjet publike duhet të qeverisen në përputhje me interesin publik. Shteti i kapur nënkupton që vendimmarrja u shërben interesave të ngush-

ta. Dhe kjo u vërtetua kur me qeverinë Kurti gjetëm 17 ndërmarrje publike me humbje, buzë greminës së falimentimit dhe vetëm 3 ndërmarrje me bilanc financiar pozitiv. Kjo gjendje reale tregon se këto ndërmarrje ishin banka familjare të pushtetarëve dhe, jo siç duhet të jenë, shtyllë për zhvillim ekonomik të vendit. Qeveria Hoti po punon për shtetin e kapur dhe kundër Kushtetutës e ligjit", ka shkruar Hajdari në llogarinë e vet në "Facebook".

BORDET E EMËRUARA DHE PËRBËRJA E TYRE:

Bordi i përkohshëm i KEK-ut:
Hysen Fazliu, kryesues, drejtor
Egzon Berisha, drejtor;
Petril Ibrahim, drejtor
Fatime Grajcevc, drejtoreshë

Bordi i përkohshëm i KRU "Prishtina":
Labinot Dedushi, kryesues, drejtor
Agim Miftari, drejtor
Arlind Haziri, drejtor
Linda Spahiu, drejtoreshë

Bordi i përkohshëm i "Ibër Lepencit":
Marigona Hamdija, kryesuese, drejtoreshë
Afërdita Llumica, drejtoreshë
Enver Rustemi, drejtor
Dejan Radojkovi, drejtor

Bordi i përkohshëm i KRU "Hidroregjioni Jugor":
Zambeze Guraziu, kryesuese, drejtoreshë
Edmond Hoxha, drejtor
Mirzet Dzagovic, drejtor
Agron Shala, drejtor

Bajrami: Programi për reforma në ekonomi adreson edhe rritjen e punësimit

PRISHTINË, 4 GUSHT (ER) - Programi për reforma në ekonomi 2021-2023 synon performancën për transformimin e ekonomisë dhe identifikohen mundësitë reale të rritjes ekonomike vjetore. Kështu ka deklaruar

ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, në takim konsultativ për procesin e hartimit të këtij programi. "Ne kemi një rrugë të qartë për adresimin e buxhetit dhe ekonomisë. Programi, gjithashtu, adreson edhe për

rritje ekonomike dhe rritje të punësimit", ka thënë Bajrami. Ajo ka folur për rishikimin e buxhetit dhe rënien e të hyrave buxhetore deri në fund të vitit si pasojë e pandemisë. Takimi pas fjalimit të ministres Bajrami është

mbyllur për media. Në takim kanë marrë pjesë edhe ministri i Bujqësisë, Besian Mustafa, ai i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi dhe ai i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi.



Bahtiri kërkon nga inspektorët dhe policia zbatimin e masave kundër Covidit

MITROVICË, 4 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka mbajtur një takim me zyrtarët komunalë nga Drejtoria e Inspeksionit, drejtoreshën e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj-Barani, si dhe komandantin e Stacionit Jugor të Policisë, Ahmet Xhoshja, me të cilët është koordinuar për zbatim më të mirë të masave për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 në këtë komunë. Me këtë rast, kryetari Bahtiri ka kërkuar nga inspektorët komunalë dhe Policia e Kosovës që të jenë më vigjilentë në zbatimin e masave, në mënyrë që qytetarët t'u përmbahen vendimeve dhe rekomandimeve nga IKShPK-

ja. Gjithashtu, në këtë takim është përcaktuar orari i inspektimeve për zbatimin e masave, ku inspektorët komunalë në bashkëpunim me policinë do ta zhvillojnë aksionin e tyre çdo ditë nga ora 19:00 deri pas mesnate, duke u ndarë në tri grupe dhe me asistim të Njësisë Speciale për intervenime në ato lokale të cilat paraqesin probleme. Duke e parë rritjen e vazhdueshme të numrit të rasteve me Covid në Mitrovicë, kryetari Bahtiri u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që t'i respektojnë në maksimum rekomandimet nga IKShPK-ja, pasi në këtë mënyrë mbrojnë shëndetin e tyre, të familjarëve, por edhe të gjithë shoqërisë.



Fillon rregullimi i tri rrugëve në fshatin Astrazup të Malishevës




MALISHEVË, 4 KORRIK (ER) - Në fshatin Astrazup të Komunës së Malishevës ka filluar rregullimi i tri rrugëve në tri lagje të ndryshme të këtij fshati. Në fillimin e punimeve ishin të pranishëm kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, drejtori i Urbanizmit, Ahmet Morina, të cilët janë pritur nga asambleisti i këtij fshati, Halil Morina, dhe nga banorë të tjerë. Me këtë rast, kryetari

Begaj është shprehur i kënaqur me fillimin e punimeve në këto rrugë, të cilat kanë rëndësi të madhe për banorët e këtyre lagjeve. Ndërsa asambleisti i Kuvendit Komunal të Malishevës, Halil Morina, ka falënderuar autoritetet komunale për fillimin e punimeve në këto rrugë pasi, sipas tij, ato kanë qenë kërkesa të kamotshme të banorëve të këtyre lagjeve. Në

anën tjetër, drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ahmet Morina, ka bërë me dije se rregullimi i rrugëve në Astrazup është pjesë e planifikimeve për realizimin e projekteve kapitale për këtë vit dhe bëhet fjalë për tri rrugë me një gjatësi prej 1200 metrash. Në këtë kontekst, ai ka thënë se këto rrugë financohen nga buxheti i Komunës së Malishevës.

Miratohet pakoja emergjente për t'i ndihmuar bizneset dhe qytetarët e Suharekës

SUHAREKË, 4 GUSHT (ER) - Asambleja Komonale e Suharekës ka miratuar pakon emergjente për t'u dalë në ndihmë bizneseve dhe qytetarëve për shkak të situatës me pandeminë Covid-19. Kryetari i kësaj komune, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se kjo pako është miratuar unanimisht nga asambleistët e të gjitha partive. "Asambleja Komonale unanimisht miratoi pakon emergjente për lehtësimin e bizneseve dhe personave fizikë për 2020 në tërë territorin e Komunës së Suharekës", ka thënë Muharremaj.



Kastrati e Abrashi inspektojnë punimet në rrugën "Nënë Tereza"

Kamenicë, 4 gusht (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, së bashku me nënkryetarin Faton Jakupi dhe zyrtarë të tjerë, të hënën kanë pritur në takim ministrin e Infrastrukturës, Arban Abrashi. Pas takimit, ata së bashku kanë vizituar punimet në asfaltimin e rrugës "Nënë

Tereza" në Kamenicë. Kryetari Kastrati ka thënë se kjo rrugë do të shërbejë si lehtësim për lëvizjen e qytetarëve. "Kjo rrugë e cila lidhë bulevardin, Shtëpinë e Kulturës e rrugën dytësore rreth lumit, do të shërbejë si lehtësim për lëvizjen e qytetarëve të Kamenicës. Vazhdojmë punën për qytetarët tanë", ka thënë Kastrati.

POPULLI SHQIPTAR E NJEH MIRË UÇK-në (23)



Shkruan: Kudsi LAMA

Duke lexuar këto pjesë deklarimesh të krijuar ideja sikur nuk flitet për vendin ku jetojmë ne, por për një vend tjetër me të cilin nuk kemi asnjë lidhje dhe nuk jemi parë kurrë. Siç duket, më mirë e dinë Serbia dhe Dick Marty se çfarë ndodh tek ne sesa e dimë vetë; siç duket më shumë na duan neve Serbia dhe Dick Marty sesa e duam ne veten tonë; siç duket më të shqetësuar janë Serbia e Dick Marty për të ardhmen tonë sesa ne vetë që do ta ndërtojmë e do ta jetojmë vetë dhe me pasardhësit tanë. Ky është mashtrimi më banal që mund të besojë njeriu, por ja që i kemi kujdestarët edhe për këto çështje, kemi Serbinë dhe megafonin e saj Dick Marty-n; atyre duhet t'u kërkonim e t'u kërkojmë ndihmë për të na shpëtuar nga UÇK-ja, që na paska ardhur prej se dimë nga ku dhe që paska në program shkatërrimin tonë si popull e si komb.

UÇK-në ky popull shqiptar e njeh mirë, se ajo nuk ishte një instrument UFO-sh, por ishin djemtë dhe vashat e këtij populli, ishte edukata e këtij populli, ishte gjaku i këtij populli, ishte ndezur për liri, ishte shpresa e shqiptarëve për ta ndërtuar jetën dhe ardhmërinë e tyre, ishte qytetaria shqiptare që nuk mund të jetonte më në robëri, ishte dëshira shqiptare për t'u bërë si të tjerët. E këta djem e vasha shqiptarët nuk i kanë frikë, se askush nuk ka frikë nga familjarët e vet. E udhëheqësit e kësaj ushtrie dhe luftime ishin djem dhe vasha të farkëtuar në veprimtarinë e gjatë kombëtare, nuk ishin të rekomanduar të dikujt, ndoshta atë keni pasur dëshirë ju që të ishin të rekomanduarit tuaj, siç jeni mësuar prej një shekulli, por kësaj radhe nuk ndodhi ashtu dhe shqiptarët fituan.

Jo zotërinj serbë dhe zotëri Dick i Evropës, nuk do të kërkojmë të na shpëtoni ju nga liria jonë të cilën e kemi dhuratë nga lufta e atyre që ju na i paraqitni si rreziku ynë; atyre që për lirinë e vunë veten para armëve tuaja dhe nuk u trembën, por u ndeshën deri në vetëmohim, ku shumë prej tyre u bënë dëshmorë të atdheut vetëm që ju të mos jeni më kujdestarët

tanë. Ju mund të vazhdoni të shpifni, por ne e dimë kush jemi, e dimë kush është UÇK-ja, e dimë kush janë udhëheqësit tanë dhe kur të bëjnë gabime i korrigjojmë vetë e, ndoshta, kur ndonjëri e bën borxh edhe e dënojmë, por kurrë jo sipas këshillave serbe. "Krahas kontrabandës së narkotikëve, grupet e organizuara kriminale nga Kosovë - Matohia merren edhe me tregtinë ilegale të armëve, me cigaret dhe mallrat e tjera akcizë, me automjete të vjedhura, me kontrabandën e mishit të bardhë dhe me rishitjen e organeve të njerëzve".¹

Besoj gjithkush e kupton mirë se sa të lehtë e ka pasur zotëri Marty ta përpilojë raportin e vet në qoftë se e ka shkruar vetë e nuk i është dhënë i gatshëm. Akuzat që shpifën më sipër janë identike si të raportit. Është shumë e habitshme si ka koiciduar që të dy raportet, ai i 2004-s dhe ai i 2010-s, ta kenë të njëjtën terminologji dhe të njëjtat shpifje akuzuese për Ushtrinë Çlirimtare dhe drejtuesit e saj, të cilët, meqenëse janë kundër dhe në luftë me Serbinë, nuk janë tjetër veçse kriminelë, që janë të aftë të bëjnë të gjitha krimet e mundshme, çfarë kanë lexuar serbët dhe Dick Martyn në librat e shkruara për mafinë botërore në gjithë historinë e saj.

"Duke pohuar se kriminelët shqiptarë kanë pasur rolin kryesor në krimin e organizuar edhe në vende të shumta të Evropës, veçanërisht në lidhje me tregtinë e narkotikëve, përfaqësuesit e Këshillit të Evropës, në raportin e tyre të vitit 2000 kanë vërejtur se krimi i organizuar në Kosovë - Metohi është i lidhur me ish-pjesëtarët e UÇK-së dhe me kriminelët nga Shqipëria e Veriut. Sipas gjetjeve të zyrtarëve evropianë, krahas veprimtarive kriminale të përshkruara, në Kosovë - Metohi janë përfaqësuar edhe tregtia me njerëzit, me forcë, përfaqësuesit e organeve të policisë dhe të gjykatave, si dhe dhunë mbi baza nacionale, gjatë së cilës spastrimi etnik është trajtuar si biznes i leverdishëm. Kështu, gjatë vitit 2000 "mediat perëndimore e kanë përshkruar Kosovë - Metohinë si 'ferr gangsterësh', përkatësisht si territorin që udhëheqësit evropianë gjithnjë e më shpesh e shikojnë si bazën e kriminit të organizuar, sidomos të tregtisë me drogën".²

Kush e beson që kriminelët shqiptarë paskan pasur rolin kryesor në krimin e organizuar në Evropë? Vetëm serbët dhe

Dick Marty, apo ka edhe të tjerë? Natyrisht që në gjithë këtë propagandë ka edhe të tjerë, se po të mos kishte nuk do të kishte arritur dot zotëri Marty, ta bindte Këshillin e Evropës, por ajo që më vjen në mendje është: Ne shqiptarët paskemi vendin e parë në Evropë e, ndoshta, në Botë për organizimin e kriminit; dhe dihet që organizimi i kriminit është shumë i vështirë se, përveçse kërkon mjeshtri për t'i dominuar sivëllezërit e organizatës, por edhe gjithë trysninë dhe luftën që të bën shoqëria, ligjet njerëzore,



opinionin, konkurrenca etj.; pse pra Evropa e bota nuk na e jep vendin e parë edhe në art, në shkencë, në kulturë, në politikë, në diplomaci etj? Sa dorëlëshuar qenka e para Serbia e pas saj edhe Evropa për të na vënë në vend të parë si kriminelë. Por ne e dimë se çdo të mirë që kemi mësuar, por edhe çdo të keqe e kemi mësuar nga ata që kanë qenë më të zhvilluar se ne e më të mëdhenj se ne, kështu i takon që shumë gjëra ne shqiptarët i kemi mësuar nga Evropa e edhe nga Serbia që na ka mbajtur një shekull të pushtuar, pra edhe organizimin e kriminit. Asgjë nuk lind pa një model. Nëse Evropa, Serbia dhe Bota pranojnë që modelet i marrin nga ne shqiptarët, edhe ne do të pranojmë që ndoshta jemi jo baba i mirë, por baba i kësaj bote që po na akuzon.

Dhe ajo që është më interesante edhe brenda ndër shqiptarë, Serbia dhe zoti Marty bëjnë diferencime, nuk i futin të gjithë në një thes. Pra, edhe këtu nuk janë të gjithë shumë të zotë në këtë fushë, por disa edhe janë: "ish-pjesëtarët e UÇK-së dhe me kriminelët nga Shqipëria e

Veriut". Shumë të zotë ata djem a vasha që krijuan UÇK-në dhe na çliruan nga pushtimi shekullor serb, por që të jenë më të zotë në Evropë në fushën e organizimit të kriminit, që është fusha më e vështirë e kur është kjo fushë e zotëruar prej tyre, natyrisht se fushat e tjera nuk i kanë fare të vështira t'i zotërojnë e të dominojnë. Këtë e vërtetuan me vepra; ata vërtetuan se janë luftëtarë të papërballueshëm sepse hodhën jashtë armikun dhe çliruan atdheun, se janë atdhetarë me bindje dhe arritën të marrin

prishen interesat, bëhesh edhe agresiv. E këtë është e kuptueshme që e bëjnë serbët duke u vënë shqiptarëve gjithfarë epitetesh fyese e akuzuese. Për këtë unë kam pretendimin pse ne nuk merremi me demantimin e tyre dhe me akuza e shpifje të nivelit siç merren edhe serbët. Por zotërinë Marty me urrejtjen e tij të deklaruar patologjike për shqiptarët nuk e kuptoj fare, po fare.

"Territori i Kosovë - Metohisë, për sa i përket kriminit të organizuar është ndarë në tri zona kryesore interesi: qarku i Drenicës, i Dukagjinit dhe i Llapit, në të cilat veprimtarinë kriminale e kontrollojnë disa udhëheqës të ish-UÇK-së, tani udhëheqës në strukturat politike, si dhe më parë, bashkëpunëtorë të ngushtë të AKSh-së, të cilët kanë financuar punën e saj".³

Pasqyrë të plotë i ka dhënë Serbia zotëri Martyt për raportin, prej të cilit ai ka shfrytëzuar vetëm ato pjesë që i janë nevojitur për momentin siç është "grupi i Drenicës", pasi me të tjerët nuk guxon të merret, pasi me ta si me Dukagjinin ashtu edhe me Llapin e ka humbur gjyqin.

"Zona e Drenicës, përgjatë rrugëve strategjike, që lidhin territorin e Malit të Zi me Maqedoninë nëpërmjet Prizrenit, Klinës, Istogut, drejt Mitrovicës, në qarkun e Shalës, paraqet zonën që kontrollojnë grupi i Drenicës, besnike e Hashim Thaçit. Ky grup merret me tregtinë ilegale të armëve me automjete të vjedhura, me njerëz, me mallra akcizë, para së gjithash me cigare dhe me karburante. Nëpërmjet lidhjeve familjare që ka në këtë zonë, Thaçi kryen drejtpërdrejt kontrollin mbi institucionet vendore, duke siguruar, në këtë mënyrë, kryerjen e veprimtarisë së përmendur kriminale. Familja Thaçi është lidhur me mafien shqiptare, maqedonase, bullgare dhe çeke".⁴

¹ Obiliç, Millosh, "Engjëjt e zinj të skëtërrës kosovare", dosjet "sekrete", Beograd, 2004, faqe 28, botimi serbisht

² Obiliç, Millosh, "Engjëjt e zinj të skëtërrës kosovare", dosjet "sekrete", Beograd, 2004, faqe 28 - 29, botimi serbisht

³ Obiliç, Millosh, "Engjëjt e zinj të skëtërrës kosovare", dosjet "sekrete", Beograd, 2004, faqe 30, botimi serbisht

⁴ Po aty faqe 30



Ibrahim Kelmendi, Hashim Thaçi, Danjean Arnaud i DGSE-së franceze, dhe Bilall Sherifi, Köln me 8 qershor 1999

Ibrahim Kelmendi, më vjen keq për ty ku e ke katandisur veten! Nuk të pranojnë as për dëshmitar!



Bardhyl MAHMUTI

Kohën e fundit kam qenë i ngarkuar me punë të tjera dhe nuk e kam parë që ti, Ibrahim Kelmendi, në cilësinë e "informatorit" i ke shkruar një letër elektronike Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Republikës së Kosovës (ZPS), në të cilën pretendon se "presidenti Hashim Thaçi nuk ishte udhëheqës politik i UÇK-së, por marionetë e shërbimit francez dhe se ka qenë i komanduar prej saj për ato që duhen bërë".

Për t'i mbështetur pretendimet tua, ti përmend takimin që keni pasur më 8 qershor 1999 në hotel "Maritim" në Köln

(Gjermani) ku, përveç teje, Hashim Thaçit dhe Bilall Sherifit na paskësh qenë edhe "shefi i Drejtorisë për Ballkanin pranë DGSE-së franceze, Arnaud Danjean". Madje, për të qenë sa më bindës në ato që thua, letrës tënde ia ke bashkëngjitur "foton si dëshmi konkrete për takimin".

Arnaud Danjean është deputet i Parlamentit Evropian dhe në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni mund t'i gjeni të dhënat e tij. Ai ka lindur më 11 shkurt 1971 dhe, rrjedhimisht, në qershor të vitit 1999, ai ka qenë më pak se 28 vjeç e gjysmë.

Fotografia që ti ia ke bashkëngjitur letrës tënde mund të manipulohet ndonjë lexues shqiptar që nuk i di gjërat, por jo edhe Prokurorinë Speciale në Hagë që ka një mijë e një mundësi ta verifikojë identitetin e personave në fotografi. Prandaj, me gënjesht

tra të tilla nuk të pranojnë as për dëshmitar!

"Foto dëshmia" jote është një sajese tepër e neveritshme që nuk ka asnjë qëllim tjetër, pos manipulimit. Për këtë arsye më poshtë do t'i publikoj fotografitë dhe le ta vlerësojnë lexuesit vërtetësinë e asaj që pretendon ti.

Në bazë të të dhënave në internet, kjo fotografi e Arnaud Danjeanit është bërë në vitin 2014, pra 15 vjet më vonë sesa takimi që pretendon ti. Siç shihet, edhe 15 vjet më vonë ky tregon më i ri se personi në "dëshminë tënde".

Ndërkaq, për shpifjet që e cilësojnë Hashim Thaçin "spion francez" nuk kam çka i shtoj më shumë asaj që kam shkruar para katër vjetësh. Prandaj, për ata që nuk kanë pasur mundësi ta lexojnë reagimin tim në atë kohë, po e publikoj në tërësi.

Propaganda kundër

Hashim Thaçit i ka rrenjët në Beograd

Autor: Bardhyl MAHMUTI

22 shkurt 2016

Në të gjitha momentet vendimtare të historisë së re të Kosovës udhëheqësit e saj janë sulmuar në mënyrën më të ulët të mundshme. Janë përdorur të gjitha mjetet për t'i denigruar personalitetet, të cilët, në këto çaste, kishin pozita kyçe. Kështu, gjatë periudhës së luftës çlirimtare në Kosovë dhe fill pas përfundimit të saj, Shërbimi Sekret Serb përgatiti dhe orkestroi një fushatë historike kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Azem Sylës, Ramush Haradinajt, Fatmir Limajt, Rexhep Selimit, Elmi Reçicës, Adem Grabovcit dhe bartësve të tjerë të UÇK-së. Mbi 27 mijë faqe materiale të

përgatitura nga Shërbimi Sekret Serb në formë CD-sh dhe mbi 2 000 faqe në formë libri u shpërndanë zyrtarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme e Jugosllavisë dhe, pas shpërbërjes së saj, nga Ministria e Punëve të Jashtme të Serbisë.

Boshti kryesor rreth të cilit pëshillej propaganda serbe kishte për qëllim që udhëheqësit e luftës çlirimtare të Kosovës të paraqiten herë si terroristë dhe udhëheqës të një strukture terroriste (UÇK-së), e herë si kriminelë dhe udhëheqës të një strukture kriminale. Shkurt, në shkrimet e përpiluesve të Shërbimit Sekret Serb, liderët politikë dhe ushtarakë të UÇK-së ishin në të njëjtën kohë terroristë dhe udhëheqës të klaneve kriminale. Sipas propagandës serbe, ata "ishin përgjegjës për vrasjen e civilëve të pafajshëm, për rrëmbimet e shumta, për bur-



Danjean Arnaud



Kush është ky person?

gosjet e paligjshme, për trafikimin e organeve njerëzore të civilëve serbë... ata merreshin me trafikimin e drogës, me emigracionin ilegal, me tregtinë me armë...”

Sa i përket kësaj propagande, ndërhyrja ushtarake e NATO-s kundër Serbisë ishte indikator më i fuqishëm për dështimin e shpifjeve të sajura nga Shërbimi Sekret Serb kundër udhëheqësve të UÇK-së.

Por, intervenimi i NATO-s për ta ndërprerë politikën e gjenocidit në Kosovë mobilizoi filozofë, publicistë, politologë, sociologë, historianë e politikanë të orientimeve politike të majta e të djathta, që kishin emërues të përbashkët “anti-amerikanizmin”, të mobilizohen në “mbrojtje të Evropës nga imperializmi amerikan”. “Antiamerikanizmi”, si këndvështrim i tyre ideologjik, bëri që, përkundër divergjencave që kishin në fusha dhe tema të caktuara, të dalin me qëndrim të përbashkët se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Azem Syla, Ramush Haradinaj, Fatmir Limaj, Rexhep Selimi, Elmi Reçica, Adem Grabovci dhe bartësit e tjerë të UÇK-së “janë spiunë të amerikanëve” që mundësuan ndërhyrjen e amerikanëve në “territorin e Evropës” duke krijuar kushtet për “ndërtimin në Kosovë të bazës më të madhe ushtarake amerikane në Evropë”.

Akuzat kundër udhëheqësve të UÇK-së për “terrorizëm”, “krim të organizuar” dhe si “spiunë të amerikanëve” shkuan duke u

shtuar pas përfundimit të luftës. Gjatë procesit të përcaktimit të statusit politik të Kosovës këto akuza u shtuan dhe kulmin e tyre e arritën pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Kulmi i kësaj fushate filloi me Carla Del Ponten.

Një muaj e gjysmë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ish-prokurorja e përgjithshme e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, Carla del Ponte, botoi librin “Përndjekja: Unë dhe kriminelët e luftës”. Sa i përket udhëheqësve të lartpërmendur të UÇK-së, në këtë libër Carla Del Ponte i përvetëson fjalë për fjalë akuzat e ngritura në “Librin e bardhë” të Shërbimit Sekret Serb.

Nga publikimi i këtij libri pasoi i ashtuquajtur “Raporti i Dick Martyt”, që paraqet një sintezë të shpifjeve dhe sajimeve të Shërbimit Sekret Serb, “Sintezë shpifjesh” që u shndërrua në Raport të Këshillit të Evropës, për të vazhduar me Task Forcën Hetimore Speciale dhe votimin nga deputetët e Kuvendit të Kosovës për krijimin e Gjykatës Speciale për krimet e supozuara të UÇK-së!

Vlen të përmendet se përkundër proceseve të montuara gjyqësore kundër Fatmir Limajt, Ramush Haradinajt, Sami Lushtakut, Sylejman Selimit, Rrustem Mustafës dhe

kundër shumë luftëtarëve të lirisë, shpifjet e lartpërmendura nuk çonin peshë tek opinioni publik shqiptar. Përkundrazi. Të bindur për faktin se shpifjet dhe akuzat e tilla ishin sajuar nga Shërbimi Sekret Serb, proceset gjyqësore kundër luftëtarëve të lirisë kishin efekt revoltën e madhe të popullit të Kosovës. Kjo revoltë shprehet më së miri në pritjet madhështore që iu bënë të gjithë të liruave nga akuzat e fabrikuar nga Shërbimi Sekret Serb.

Të gjitha problemet e lartpërmendura i kam trajtuar hollësisht në pjesën e dytë të librit tim (“Mashtrimi i Madh”, f. 397-560). Të interesuarit për vërtetësinë e pohimeve që solla në këtë shkrim të shkurtër mund t’i konsultojnë referencat që sjell në libër.

Ajo që më shtyri të reagoj, duke rikujtuar shpifjet dhe akuzat që u sajuan nga Shërbimi Sekret Serb, ka të bëjë me një fushatë historike që përpiqet ta paraqesë Hashim Thaçin si “spiun të Francës...” E shoh të udhës të reagoj sepse këtu kemi të bëjmë me një kontekst të ri historik dhe me një periudhë të re të luftës speciale kundër luftës çlirimtare të Kosovës.

Për dallim nga periudha paraprake kur ish-udhëheqësit e UÇK-së kishin një minimum solidariteti përball padrejtësive që u kanoseshin, përkundër divergjencave që kishin në mes tyre në fusha të ndryshme, tani kemi një situatë ku divergjencat rrezikojnë të shndërrohen

në armiqësi “brenda llojit”. Nuk më takon mua “të ndaj drejtësi” se kush është “më shumë” apo “më pak” fajtor për situatën e krijuar. Ajo që shihet është e tmerrshme. Shpifjet dhe akuzat e sajura nga shërbimet antishqiptare po shpërndahen edhe nga njerëzit që vepruan për dekada të tëra në të njëjtat struktura organizative. Qëllimi im nuk është të polemizoj me asnjërin prej tyre sepse kjo histeri shpifjesh ka kaluar caqet individuale. Prandaj nuk po ua përmend emrat. Por, siç thotë një shprehje popullore: “Në kofsh Bektesh, e merr vesh”!

Nuk ka turp më të madh ku shpifjet e një ish-zëvendës-drejtorit teknik të njërit nga Shërbimet Sekrete të Francës (Shërbimit të Jashtëm) të përhapen në mediat shqiptare me tituj bombastikë se gjoja “sipas ish-shefit të shërbimit francez Pierre Siramy, Hashim Thaçi është agjent i Francës!” Poshtërsia është edhe më e madhe kur të njëjtën dezinformatë e shpërndajnë njerëzit me të cilët kemi vepruar bashkë.

Sikur t’u kishte interesuar e vërteta lidhur me këto “pretendime”, secili do të kishte mundur të bindej se prapa Pierre Syramit nuk qëndron asnjë shef i Shërbimit Francez, por bëhet fjalë për pseudonimin e Maurice Dufresse, një ish-zëvendës drejtor teknik, i pensionuar për “çështje shëndetësore” dhe i cili ka botuar një libër, ndaj të cilit janë ngritur disa padi për shpifje.

Sikur t’u kishte interesuar e vërteta, para se të botonin shpifje të rënda, do të ishin bindur se në librin “Dëshmia e Pierre Siramyt, 25 vjet në shërbimet sekrete” në 793 faqe të shpërndarë falas përmes internetit (http://data.over-blog-kiwi.com/0/94/25/77/20140225/ob_8bd82e_25-ans-dans-les-services-secrets-siramypierre.pdf), as edhe një fjalë e vetme për Hashim Thaçin!

Kujt i shkon përshtati që në kohën kur pritët që të themelohet Gjykata Speciale të futë thika të tilla me qëllim që divergjencat e ish-shokëve tanë të shndërrohen në armiqësi. Meqenëse disa ish-bashkëveprimtarë më janë drejtuar publikisht nëpërmes profileve të tyre të “Facebook”-ut që ta jap mendimin tim lidhur me “pretendimet” se gjoja “Hashim Thaçi është spiun francez”, e shoh të udhës që të shprehem publikisht rreth kësaj çështjeje.

Gjatë veprimtarisë së përbashkët diplomatike me Hashim Thaçin (si përfaqësues politik i UÇK-së, në kuadër të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës dhe në kuadër të PDK-së), Hashim Thaçi ka dëshmuar një konsekuencë të vazhdueshme në qëndrime. Në qindra takime që kemi pasur me

përfaqësues të niveleve të ndryshme politike dhe shtetërore ndërkombëtare, Hashim Thaçi ka mbrojtur qëndrimin se pavarësia e Kosovës ishte zgjidhja e vetme e mundshme që do ta garantonte stabilitetin në Ballkanin Perëndimor. Në të gjitha takimet që kemi pasur pas luftës, Hashim Thaçi insistonte me ngulm për lirimin e menjëhershëm të të gjithë shqiptarëve që ishin marrë peng nga regjimi i Millosheviqit dhe në mesin e tyre, në çdo takim ka përmendur Albin Kurtin dhe Nait Hasanin. Në të gjitha takimet diplomatike Hashim Thaçi insistonte në domosdoshmërinë e presioneve ndërkombëtare për ndriçimin e fatit të atyre që konsideroheshin të zhdukur dhe në këtë kontekst nuk e linte pa përmendur rastin e politologut Ukshin Hoti dhe veprimtarit të njohur Xhavit Haziri...

Për mua është e qartë se prapa Pierre Siramysë dhe të gjithë atyre që bëjnë propagandën e lartpërmendur qëndron Serbia. Të gjithë bashkëveprimtarëve u drejtohem me një këshillë: divergjencat eventuale që mund të kemi mes nesh, nuk duhet të na verbojnë deri në atë shkallë sa të heshtim para shpifjeve, për të cilën thellësisht jemi të bindur se janë të sajura nga shërbimet sekrete antishqiptare.

Është e drejtë e secilit prej nesh të ketë mendimin e vet se çfarë presidenti i duhet vendit. Dikujt mund t’i duket e arsyeshme që Hashim Thaçi të zgjidhet në këtë funksion në përputhje me marrëveshjen PDK-LDK; dikujt mund t’i pëlqente që në vend të tij të ishte Isa Mustafa, në përputhje me marrëveshjen e përparshme të VLAN-it, e dikujt tjetër mund t’i pëlqejë një i tretë. Kjo është çështje pikëpamjesh dhe pozicionesh në garën politike.

Por, të gjithë e dimë se Hashim Thaçi nuk është spiun as i Francës e as i ndonjë shteti tjetër, siç e dimë se propaganda që bëhet kundër babait, gjyshit dhe stërgjyshit të Hashim Thaçit është propagandë e sajura në Beograd, pikërisht për shkak të veprimtarisë që Hashim Thaçi ka zhvilluar kundër Serbisë gjatë luftës çlirimtare, gjatë procesit të përcaktimit të statusit final të Kosovës, në shpalljen e pavarësisë së Kosovës...

Propaganda e Shërbimit Sekret Serb ka vërshuar Kosovën. Nëse dikush pa vetëdije ka rënë në grackë të kësaj propagande është momenti që të tërhiqet, sepse kjo fushatë historike nuk dëmton vetëm Hashim Thaçin, por Kosovën në rend të parë. Ndërsa, ata që me vetëdije (me pagesë apo pa pagesë) shpërndajnë këtë propagandë, jam plotësisht i vetëdijshëm se do ta vazhdojnë avazin e diktuar nga padronët e tyre! Atyre u them: qafën e thefshi!

E rrallë

14-vjeçarja mban gjashtë gjarpërinj si kafshë shtëpiake

Një vajzë 14 vjeçe nga Indonezia është duke marrë shumë vëmendje në mediat sociale falë kafshëve të pazakonta. Chalwa ka gjashtë gjarpërinj gjigantë që i pëlqen t'i mbajë si kafshë shtëpiake. Shumica e njerëzve kanë frikë nga gjarpërinjtë e veçanërisht nga ata të cilët duken se mund ta gëlltisnin një njeri me lehtësi. Mirëpo adoleshentja indoneziane nuk ka aspak frikë dhe, po ashtu, ndan shtëpinë me gjashtë gjarpërinj masivë. Fotografitë dhe videot e



vajzës indoneziane duke luajtur me ta, janë virale në "TikTok" dhe "Instagram", duke bërë që shumë shikues të mbesin gojëhapur.

BARSOLETA E DITËS



Pasagjeri: Sa kushton të më dërgosh deri në aeroport?
Taksisti: 15 euro.
Pasagjeri: Po nëse marr edhe të dashurën me vete?
Taksisti: I njëjti çmim.
Pasagjeri: E sheh zemër që nuk vlen asnjë euro.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje



FOTO E DITES



Kryeministri i Italisë, Giuseppe Conte, merr pjesë në ceremoninë e inaugurimit të urës së re në Genoa, e cila ishte shembur dy vjet më parë.

E jashtëzakonshme

Krijohet akropoli i detit


Është krijuar muzeu i parë nën det. E kanë titulluar "Akropoli i detit" dhe bëhet fjalë për një anije të epokës së Greqisë së Lashtë, e gjetur nën ujërat mes Peristera dhe Alonissos, në zonën verilindore të vendit. Ai është hapur për herë të parë, duke bashkuar antiken dhe inovacionin, me objektivin edhe për sensibilizim mbi argument si ruajtja e ekosistemeve dhe trashëgimisë. Teknologjia është pjesë mjaft e rëndësishme e këtij muzeu, pasi janë instaluar një rrjet i tërë telekamerash, por edhe një software për ruajtjen e vendit arkeologjik, gjë që deri më sot nuk ishte realizuar kurrë më parë. Anija e mbytur në shekullin e V p.e.s në

brendësi të saj ka ende 3 500 amfora dhe enë që shërbenin për tregti mes popujve në ujërat e Mesdheut. Sipas studiuesve, mendohet se këto amfora kanë qenë të mbushura me verë dhe hedh dritë mbi flukset tregtare të periudhës, që ndryshe quhet edhe si periudha e Arte e Athinës, duke mbartur një rëndësi historike. Të zhytesh atje poshtë dhe të mundësh të shohësh me sy këtë mrekulli që mbërrin nga 2500 vjet larg nesh, është diçka e jashtëzakonshme, shpjegojnë arkeologët që e kanë studiuar. Akropoli i detit, është një projekt pilot, i pari i kësaj natyre dhe mund të jetë pikënisja për kthimin në të tillë edhe të siteve të tjera arkeologjike nënujore në Greqi.

 <p>DASHI Gjëja e vetme që mund të bëni është që ta braktisni plotësisht monotoninë, të çlodheni, të përjetoni momente intime dhe romantike me partnerin tuaj.</p>	 <p>DEMI Përfitoni nga kjo periudhë për të filluar projekte të reja. Do të jeni shumë produktiv dhe nuk do të mashtroheni nga askush.</p>	 <p>BINJAKËT Në këtë periudhë gjithçka duhet të shkojë mirë: pushimet, marrëdhëniet emocionale, seksi dhe puna. Dhe kjo është një ftesë e qartë për t'i përmirësuar cilësitë tuaja.</p>	 <p>GAFORRJA Dita ideale për të përfunduar atë që ka mbetur nga dembelizmi dhe të vendosni të bëni diçka të veçantë për ditët në vazhdim, siç është futja në një filozofi të re të jetës.</p>	 <p>LUANI Përfitoni nga yjet për ta zgjeruar rrethin e miqësive, bashkëpunimeve dhe për ta forcuar jetën shoqërore. Do të ishte turp nëse do të qëndronit vetëm!</p>	 <p>VIRGJERESHA Yjet ju bëjnë thirrje të guxoni, t'i shfrytëzoni mundësitë për të bërë diçka të rëndësishme për të ardhmen ose për ta kërkuar autonominë tuaj. Sfera profesionale është e pasur me stimul dhe po kështu është edhe jeta shoqërore.</p>
 <p>PESHORJA Një bashkëveprim i mirë ju lidh edhe më shumë me partnerin tuaj, duke dëshmuar se jeni personi ideal për të jetuar së bashku ëndrrat tuaja të dashurisë.</p>	 <p>AKREPI Përpiquni të jeni të qetë dhe ta gjeni ngushëllimin te familja juaj. Klima në shtëpi do të jetë e ngrohtë dhe do t'ju strehojë nga paqartësitë që keni ndaj botës.</p>	 <p>SHIGJETARI Ditë ideale për të qenë në shoqëri, për ta demonstruar kreativitetin dhe për t'u argëtuar. Ju jeni në gjendje të shprehni pa rezervë anë të mira të personalitetit.</p>	 <p>BRICJAPI Kini kujdes që të mos shkëlqejnë rregullat, jini të kujdesshëm në drejtimin e sporteve dhe lëvizjeve. Në aspektin ekonomik, ndoshta jo sot, por së shpejti do të keni mundësi të merrni atë që meritoni.</p>	 <p>UJORI Vështrimi juaj thotë shumë gjëra, në sytë e tu do të shihet një lumturi e madhe nga pikëpamja sentimentale.</p>	 <p>PESHQIT Ju keni një vizion të qartë se çfarë ka ndodhur, ju mund të shihni qartë se kush ka qenë miku juaj dhe kush ka komplotuar pas jush.</p>

Bikinit e vogla për përmasat e Demi Roses

Demi Rose ka vënë në fokus gjoksin bombastik. Ajo ka ngacmuar sërish ndjekësit në "Instagram", me fotografinë e fundit të publikuar në këtë rrjet social. Supermodeluesja nga Britania e Madhe në imazhin e ndarë është shfaqur në bikini dhe ka vënë në fokus gjoksin "bombastik". Demi është e ndjekur nga 14 milionë persona në "Instagram" dhe imazhe të tilla zgjojnë kureshtje të madhe tek audiencia.



Pa reçipeta dhe super seksi, Era Istrefi pozon para makinës luksoze

Pak ditë pasi ka paralajmëruar rikthimin në muzikë, në një bashkëpunim me Butën, Era Istrefi është rikthyer sërish në qendër të vëmendjes. Ajo është shfaqur tepër seksi brenda makinës luksoze dhe ajo që bie në sy është që veshur nuk mbante reçipeta. Sakaq, hera e fun-

dit që Era Istrefi ka realizuar një projekt shqip ka qenë ai me motrën e vet, Norëm, "Nuk e di", në prill të 2019-s. Ndërsa bashkëpunimi i fundit ndërkombëtar ka qenë ai me Ikaly Sencan dhe Arash, "No Maybes", i publikuar gjatë periudhës së izolimit nga pandemia në mars të këtij viti.

Kryeministrja e Finlandës i jep fund beqarisë pas 16 vjetësh bashkëjetesë




Kryeministrja e Finlandës, Sanna Marin, ka qenë në qendër të mediave botërore për shkak të moshës së re, 34 vjeçe, si drejtuese e një vendi dhe ndërtimit të një kabineti përgjithësisht me femra. Përmes një postimi në rrjetet sociale, kabineti i saj ka njoftuar se

kryeministrja i ka dhënë fund beqarisë. Ajo është martuar me personin që ka ndarë 16 vjet të jetës së saj dhe ka ndarë me publikun disa foto nga martesja. Ajo shfaqet me një fustan të bardhë, tufë lulesh në dorë dhe në krahët e bashkëshortit të saj, Markus Raikonen.

Dua publikon foto nga shtrati me të dashurin

Dua Lipa dhe i dashuri saj Anwar Hadid janë parë gjithmonë në shoqërinë e njëri-tjetrit këtë periudhë. Madje ata nuk kanë ngurruar që të shpërndajnë çaste intime me ndjekësit në rrjete sociale. Në foton e fundit të publikuar, dyshja shihet e shtrirë në shtrat, ndërsa në mes tyre është edhe qeni të cilin sapo e kanë adaptuar, Dexter. Kujtojmë se Dua dhe Anwar kanë një vit që shoqërohen së bashku, ndërsa së fundmi kanë nisur të bashkëjetojnë.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

'Nikli' vazhdon me risi, Greca transferi me i ri

Feronikeli ka rikthyer në klub Artan Berisha dhe Ragip Veseli. Gjithashtu ky klub e ka transferuar edhe futbollistin e njohur Bedri Greca, i cili në të kaluarën ishte pjesë e skuadrës së Gjilanit. Ish-kampionët e Kosovës kanë paralajmëruar edhe transferime të tjera gjatë ditëve të ardhshme



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 GUSHT - Skuadra e Feronikelit dështoi të mbrojë titullin e kampionit dhe Kupën e Kosovës dhe po ashtu mbeti jashtë garave ndërkombëtare, por nuk po i pengon drejtuesit e klubit që të vazhdojnë me risi. Të martën "Nikli" ka konfirmuar se janë rikthyer në klub Artan Berisha dhe Ragip Veseli. Veseli do të jetë zëvendësuesi i klubit, ndërsa Berisha do të marrë pozitën e drejtorit të përgjithshëm. "Përveç ardhjeve të reja në futbollistë, FC Feronikeli është përforcuar edhe në aspektin administrativ. Artan Berisha dhe Ragip Veseli janë edhe zyrtarisht pjesë e klubit, me besimin e plotë të presidentit Ramaj. Dyshja Veseli dhe Berisha pritet ti japin freski klubit, pas një edicioni jo të mirë në sezonin 2019/20. Ragip Veseli vjen në pozitën e zëvendësuesit të klubit, ndërsa Artan Berisha në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm", thuhet në njoftimin e Feronikelit. Po ashtu të martën ky klubi konfirmoi edhe transferimin

futbollistit të njohur nga Shqipëria, Bedri Greca. 30-vjeçari edhe me herët ka luajtur në Kosovë, kurse ishte pjesë e skuadrës së Gjilanit. Edicionin e fundit Greca luajti për klubin e Laçit. "Bedri Greca rikthehet në Superligën e Kosovës. Pas një periudhe të kaluar te SC Gjilani, Greca është rikthyer përsëri në Superligën e Kosovës. Greca i është bashkuar FC Feronikelit nga Laçi, gjatë afatit kalimtar të verës, duke i dhënë shtytje sulmit të skuadrës tanë", thuhet në njoftimin e "Niklit". I njohur për depërtimet e tij dhe harkimet e sakta në zonë, Greca pritet të jetë "armë" tejet e fuqishme për Feronikelin, sidomos për repartin ofanziv. Shumicën e karrierës së tij ky futbollist e ka kaluar në Kategorinë Superiore të Shqipërisë, përkatësisht në skuadra si: KF Flamurtari, KF Kukësi, KF Tirana.

Benjamin Emini, besnik i Llapit

Skuadra e Llapit po tregohet mjaft aktive në afatin kalimtar. Klubi që drejtohet nga Tahir Batatina ka arritur marrëveshje të re me njërin nga futbollistët më të mirë Benjamin Emini,

i cili është pjesë e kësaj skuadre që dhjetë vite. "Bashkëpunimin edhe për një vit me Llapin e ka vazhduar edhe mbrojtësi i krahut të djathtë, Benjamin Emini. Futbollisti i ka qëndruar besnik Llapit më shumë se 10 vite do vijoj të jetë pjesë e rëndësishme e skuadrës edhe në edicionin e ri", thuhet në njoftimin e Llapit. Emini në edicionin që lamë pas ka zhvilluar 28 paraqitje (27 kampionat/1 kupë) duke kontribuar me 1 gol e 1 asistim në gjithsejtë 2407 minuta të luajtura.

Leart Emini ndahet me Trepçën '89

Futbollisti i njohur Leart Emini është larguar nga skuadra e Trepçës '89. Lajmin e ka konfirmuar vet futbollisti me anë të një postimi në profilin e vet në "Facebook". "Nga sot nuk të jam pjesë e klubit Trepça '89. Faleminderit kryesisht, shtabit teknik dhe të gjithë bashklojtarëve për këtë vit të kaluar se bashku. Klubit i dëshiroj sukses në vitin e ardhshëm", ka shkruar Emini, i cili ka luajtur me sukses edhe për Llapin, Ballkanin dhe Besën e Pejës.

SHKURT

Rapid Wien interesohet për Blend Baftiun

Pas një sezoni të jashtëzakonshëm nën fanellën e Ballkanit, Blend Baftiu mund të transferohet në Evropë. Baftiu është pranë kalimit te skuadra e njohur Rapid Wien, raporton "Olle". "Heute", shkruan për interesimin e Rapidit për talentin prishtinas. "Baftiu është golashënuesi më i mirë në ligën kosovare, një lojtar i fortë që driblon dhe ka konkretizim të shkëlqyeshëm", shkruan gazeta e atjeshme. "Lojtari i ekipit U-21 të Kosovës ka bërë debutimin e tij me Kombëtare dhe së fundmi u votua nga UEFA në mesin e 50 talenteve më tërheqës në Evropë", thuhet tutje. Gazeta thekson faktin që Rapid ka konkurrencë nga Turqia për Baftiun, i cili kërkohet edhe nga Beshiktashi e Galatasaray.

Kameri transferohet te St Gallen

Florian Kamberi rikthehet në elitën e futbollit zviceran, ku do të luajë me St Gallen, madje do ta nisë në Ligën e Evropës, pasi skuadra zuri vendin e dytë në kampionatin helvet pas Young Boys. Hibernian e bleu Kamberin për 120 mijë euro nga Grasshoppers në vitin 2018, ndërsa në janarin e këtij viti e huazoi te Rangers. Kamberi la përshtypje të mira te kjo skuadër, por Gerrard nuk këmbënguli shumë për ta mbajtur në skuadër dhe Kameri u rikthye në futbollin zviceran.

Lazio shumë shpejt do të bëjë ofertë për Muriqin

Sipas "beIN SPORTS Turkiye", Lazio vazhdon ta vëzhgojë situatën e sulmuesit të Fenerbahçes dhe Kosovës, Vedat Muriqi. Klubi romak thuhet se do t'i bëjë një ofertë të majme klubit turk për transferimin e sulmuesit prizrenas. Muriqi është duke u kërkuar që moti nga Lazio, sidomos nga drejtori Igli Tare, teksa klubi italian i kishte bërë ofertë huazimi Fenerbahçes më herët, por që e njëjta ishte refuzuar. Lazio e ka siguruar kualifikimin në Ligën e Kampionëve për edicionin e ardhshëm, andaj kryeqytetasit kanë mundësi të mëdha për transferimin e Muriqit. Përveç Lazios, Muriqin janë duke e kërkuar edhe disa klube në Angli si Leicester City, West Bromi dhe Tottenhami. 26-vjeçari ka bërë 36 paraqitje në të gjitha garat me skuadrën turke edicionin e kaluar, derisa ka shënuar 17 gola dhe ka dhuruar shtatë asistime.

Avdyli largohet nga Kukësi, pritet kalimi te Feronikeli

PRISHTINË, 4 GUSHT - Konfirmohet një tjetër largim nga Kukësi. Portieri Ilir Avdyli, përmes një postimi në "Facebook", bën me dije se nuk do të jetë pjesë e skuadrës

verilindore në vijim. "Faleminderit për të gjitha FK Kukësi dhe shumë suksese në vazhdim", shkruan portieri. Avdyli kishte spikatur një sezon më parë te Kamza,

ndërkohë që është aktivizuar në Superiore edhe me Tiranën. "Gardiani" e nisi titullar te Kukësi, por pas disa javësh ish-trajneri Duro i besoi Dashamir Xhikës dhe pjesën më të

madhe të kampionatit qëndroi në stol. Sigurisht ai kërkon të luajë dhe me shumë mundësi do ta vijojë karrierën në Kosovë, ku e kërkon skuadra e Feronikelit.



Ukaj: Kam synime të mëdha në basketbollin amerikan

PRISHTINË, 4 GUSHT - Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë disa lojtarë/e të Kosovës që po paraqiten me sukses. Një ndër ta është edhe talenti Rron Ukaj. Basketbollisti pejan me Kosovën U-18 më 2018 kishte fituar Kampionatin Evropian, Divizioni C, ku ishte shpallur MVP i Evropianit. Ai ka luajtur për Kosovën U20 dhe është grumbulluar nga Përfaqësuesja e Kosovës A.

Ukaj flet për karrierën e vet në ShBA. "Që një vit kam ardhur në Amerikë për të luajtur basketboll në kolegji. Viti i parë ishte paksa i vështirë në fillim, sepse dallon basketbolli amerikan nga ai evropian. Në vitin e parë kam luajtur në D1 Junior College ose NJCAA në Southeastern Community College në Iowa. Ishte një edicion i mirë si për skuadrën, po ashtu edhe për mua. Pas vitit të parë kam marrë ofertë nga Eastern Florida State D1 'NJCAA' që është një ndër 5 Junior College më të mira në ShBA dhe kam vendosur të shkoj të luaj aty", ka thënë Ukaj. "Synimi im pas këtij viti është të dal në D1 NCAA dhe me punë e përkushtim do ta arrij këtë qëllim. Të luaj për Kosovën është nder dhe përgjegjësi e madhe, sepse je duke përfaqësuar shtetin tënd në arenën ndërkombëtare", është shprehur Ukaj për faqen zyrtare të FBK-së.



Lakersat rikthehen te fitorja

ORLANDO, 4 GUSHT - Los Anxhelos Lakersi rikthehet menjëherë te fitorja në NBA duke harrur disfatën ndaj Toronto Raptorsit. Kryesuesit e konferencës së Perëndimit ishin superiorë ndaj Utah Jazzit duke triumfuar me rezultatin 116-108 për meritë edhe të Anthony Davisit i cili realizoi 42 pikë në total duke udhëhequr skuadrën kaliforniane drejt suksesit të 51-të sezonal. Vazhdon të fitojë ndërkohë Toronto Raptorsi që mposhti edhe Miami Heatin me rezultatin 107-103. Van Vleet me 36 pikë ishte basketbollisti më i mirë mbi parket për skuadrën kanadeze. Fitore me rezultat minimal për Philadelphia 76-ers që kaloi me shifrat 132-130 San Antonio Spursin, ndërkohë që New Orleans Pelicansi mposhti me rezultatin 109-99 Memphis Grizzliesin.



SHKURT

Balotelli, afër CFR Cluj

Mario Balotelli po shkon të luajë në Rumani. Media vendase "GSP" raporton se ish-sulmuesi i Interit, Milanit, Manchester City, Liverpoolit dhe Brescias ka nisur bisedimet me kampionët e Rumanisë, CFR Cluj. Klubi ballkanas nuk do të pagujë asnjë para për "Super Marion" pasi futbollistit iu ndërpre kontrata nga Brescia për shkak të mosparaqitjes në stërvitje.

Sarri shkarkohet nëse dështon në Ligën e Kampionëve

Nëse skuadra e Juventusit dështon në Ligën e Kampionëve, atëherë Maurizio Sarri do të shkarkohet nga posti i trajnerit. Lajmi është bërë me dije nga mediat italiane.

Në rast se Sarri shkarkohet, emrat më të përforcuar për pasardhës të tij janë Simone Inzaghi dhe Maurizio Pochettino. "Zonja e Vjetër" të premten e zhvillon ndeshjen kthyesë në Ligën e Kampionëve kundër Lyonit, kurse ndeshjen e parë të zhvilluar në Francë e humbi 1-0.

Casillas pensionohet nga futbolli


Portieri spanjoll Iker Casillas ka njoftuar në rrjetet sociale se ka varur këpucën në gozhdë pas përfundimit të sezonit me Porto, pavarësisht se nuk ishte në gjendje të luante asnjë ndeshje për shkak të problemeve të zemrës që pësoi sezonin e kaluar. "Gjëja e rëndësishme është rruga që ju udhëtoni dhe njerëzit që ju shoqërojnë, jo destinacioni që ju merrni, sepse ai me punë dhe përpjekje vjen vetëm dhe mendoj se mund të them, pa hezitim, se ka qenë rruga dhe destinacioni i ëndrrave", ka shkruar Casillas në "Twitter". Portieri legjendar tërhiqet nga futbolli duke lënë gjurmë të mëdha, sidomos me ekipin e Real Madridit dhe kombëtaren e Spanjës. Ai fitoi pothuajse çdo trofe të mundshëm, plot 26, si në nivelin ekipor, po ashtu edhe ndërkombëtar, përfshirë Ligën e Kampionëve, Kupën e Botës e shumë trofe të tjerë individualë si portieri më i mirë.

Lewandowski: Klopp është me dy fytyra

Sulmuesi Robert Lewandowski e ka emëruar Jurgen Kloppin menaxher, ndërsa e përshkruan trajnerin e Liverpoolit si një njeri me "dy fytyra" - një baba të kujdesshëm dhe një trajner autoritativ. Klopp joshi Lewandowskin në Borussia Dortmund nga Lech Poznan në verën e vitit 2010 dhe të dy vazhduan të punojnë së bashku në "Westfalenstadion" për katër sezone. BVB fitoi dy tituj të Bundesligës dhe arriti në një finale të Ligës së Kampionëve gjatë asaj periudhe, me Lewandowskin që shënoi 103 gola në 187 paraqitje. 31-vjeçari ka punuar edhe me Pep Guardiolan, por e ka renditur të parin gjermanin: "Unë mendoj... Jurgen Klopp [është i preferuari im] dhe pas tij Pep Guardiola. 100 për qind". "[Klopp] ka dy fytyra. Ju mund të shihni se ai është si baba, por pjesa e dytë është si një trajner, një menaxher. Ai mund t'ju tregojë gjithçka - dhe unë nuk po flas për gjërat e mira - për gjërat e këqija. Edhe për [lojtarët], ai është një motiv shumë i madh. Ai e bën këtë të përsosur, sepse ai e di se ku është vendi, ku ai mund t'ju shtyjë përpara. Performanca e tij si trajner është e mahnitshme, por jo vetëm si trajner, por edhe si njeri", ka deklaruar futbollisti polak.



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN



www.uni-prizren.com

Prof. asoc. dr. Ismet Temaj

Nr. ref. 167

Data: 03/08/2020

Bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" nr. 04-V-621, Rregulloren nr. 01.111/A për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik si dhe vendimet nr. 01-162 dhe 01-166; Senati i Universitetit, shpall:

KONKURS

PËR EMËRIMIN, RIEMËRIMIN DHE AVANCIJIMIN E PERSONELIT AKADEMIK¹

I. FAKULTETI I EKONOMISË

1. Një profesor (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Bazat e Marketingut (AB, MN), E-Marketingu (AB dhe MN), Tatimet dhe Vendimarrja (Ma).
2. Një profesor (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Mikroekonomi (AB dhe MN), Bazat e Financës, Analiza Financiare (Ma).
3. Një profesor (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Menaxhmenti Komunikues Ndërkulturor, Menaxhimi i Projekteve (AB dhe MN), Sjellja e Konsumatorit, Etika Profesionale (Ma).
4. Një profesor (në përputhje me nenin 173 të Statutit) për lëndët: Organizimi i Ndërmarrjeve, Spss/Anova – Ekonometria, Makroekonomi (AB dhe MN).
5. Një profesor (në përputhje me nenin 173 të Statutit) për lëndët: Etika në Biznes (AB dhe MN), Menaxhimi i Potencialëve Turistike dhe Analiza Financiare (AB dhe MN).

II. FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

1. Një mësuesdhënë (në përputhje me nenin 173 të Statutit) për lëndët: Protokollet e Internetit (DS, sem. II, Z), Mësimi i Makinës (DS, sem. III, Z), Zhvillimi i Lojrave DS, sem. V, O), Finite Automata dhe Gjuhët Formale (TIT, sem. V, Z), Algoritmet e Selektuara (Maser sem. II, O), Tema të Zgjedhura nga Mësimi i Makinës dhe Inteligjenca Artificiale (Master, sem. III, O).
2. Një mësuesdhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Metodadat e Hulumtimit (TIT sem. IV, O), Metodadat Kërkimore (DS, sem. IV, O), Metodadat Empirike Kërkuese (Master sem. III, O), Inxhinieringu Softuerik dhe menaxhimi i Projekteve (DS sem. III, O), Dizajnimi i Sistemeve të Informacionit (DS sem. IV, Z), IT – Qeverisja (Master sem. III, Z).

III. FAKULTETI JURIDIK

1. Një profesor (në përputhje me nenin 173 të Statutit) për lëndët: E Drejta Administrative (6 orë), Procedura Administrative (6 orë).

¹ Shprehjet e përdoruar në njërin gjini nënkuptojnë çdo herë edhe gjinin tjetër.

2. Një profesor (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: E Drejta e Procedurës Penale I (Pjesa e përgjithshme) (6 orë), E Drejta e Procedurës Penale II (Pjesa e posaqme) (6 orë).
3. Një asistent (në përputhje me nenin 174 të Statutit) për lëndët: E Drejta e Procedurës Penale I (Pjesa e përgjithshme) (6 orë), E Drejta e Procedurës Penale II (Pjesa e posaqme) (6 orë), Politika Kriminale, Penologjia, Klinika Penale, Informatika dhe Krimet Kompjuterike.

IV. FAKULTETI I EDUKIMIT

Në gjuhën mësimore shqipe:

1. Një mësuesdhënë (në përputhje me nenin 173 të Statutit) për lëndët: Gjuhë shqipe I për Programin Parashkollor, Gjuhë Shqipe II për Programin Parashkollor.
2. Një mësuesdhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Metodologji e gjuhës shqipe (Programi Fillor dhe Parashkollor); Strategjitë dhe metodat e shkrimit leximit (Programi Fillor) me plotësim orësh në fakultetin e Filologjisë (Metodologji e gjuhës dhe Metodologji e letërsisë shqipe)
3. Një mësuesdhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Matematika I për Programin Fillor, Matematika II për Programin Fillor; Matematika I për Programin Parashkollor; Matematika II për Programin Parashkollor.
4. Një asistent/te (në përputhje me nenin 174 të Statutit) për lëndët: Matematika I për Programin Fillor, Matematika II për Programin Fillor; Matematika I për Programin Parashkollor; Matematika II për Programin Parashkollor, Metodologji e Mësimin të Matematikës I PF, Metodologji e Mësimin të Matematikës II PF.
5. Një mësuesdhënë (në përputhje me nenin 173 të Statutit) për lëndët: Metodologji e Edukimit Fizik (Programi Fillor), Metodologji e Edukimit Fizik (Programi Parashkollor)

Në gjuhën mësimore turke:

1. Një mësuesdhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Teoria e Mësimin: Praktika Pedagogjike II dhe III, Bazat e Hulumtimit në Edukim, Pedagogjia e Edukimit Parashkollor (Programi Fillor dhe Parashkollor).
2. Një mësuesdhënë (në përputhje me nenin 173 të Statutit) për lëndët: Psikologji e Fëmijës (Programi Parashkollor); Hyrje në Psikologji (Programi Fillor); Hyrje në Psikologji (Programi Parashkollor); Psikologji e Edukimit (Programi Fillor).

Në gjuhën mësimore boshnjake:

1. Një mësuesdhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Bazat e Shkencave Natyrore me Metodologji I (Programi Fillor); Edukimi Mjedisor (Programi Fillor); Bazat e Shkencave Natyrore me Metodologji (Programi Parashkollor); Edukimi Mjedisor (Programi Parashkollor).

V. FAKULTETI I FILOLOGJISË

Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe:

1. Një mësuesdhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Kulturë Gjuhe, Shkrim Akademik, Leksikologji, Sociolinguistikë, Dialektologji e Gjuhës Shqipe, Gjuhësi Indoevropiane, Gjuhësi Ballkanike.
2. Një mësuesdhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Letërsi Popullore, Letërsi e Vjetër Shqipe, Letërsi për Fëmijë, Letërsi Krahasimtare, Letërsi Botërore I, Letërsi e Sotme I, Letërsi Botërore II, Letërsi e Sotme II.

Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze:

1. Një mësuesdhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Fonetikë dhe Fonologji, Morfologji e Gjuhës Angleze, Anglishte për Qëllime të Veçanta I dhe II, Anglishte për Qëllime Akademike I dhe II.
2. Një asistent (në përputhje me nenin 174 të Statutit) për lëndët: Shkathësitë e Integruara II, Hyrje në Gjuhësi, Shkrim Akademik, Anglishte për Qëllime Akademike II, Anglishte për Qëllime të Veçanta I dhe II.

Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane:

1. Një mësuesdhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Gramatikë e Gjuhës Gjermane I, Morfologji e Gjuhës Gjermane, Hyrje në Didaktikën e Gjuhëve të Huaja, Metodika dhe Didaktika e Gjuhës Gjermane I, Metodika dhe Didaktika e Gjuhës Gjermane II, Seminari i Didaktikës.
2. Një mësuesdhënë (në përputhje me nenin 173 të Statutit) për lëndët: Civilizimi dhe Kultura Gjermane I, Civilizimi dhe Kultura Gjermane II, Hyrje në Teknikën e Punës së Studimit të Gjermanistikës, Qytetërim Gjerman (DACHL) Komunikimi Ndërkulturor, Gjuhësi Gjermane I dhe II (Në degën e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze).

VI. FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT

1. Një asistent (në përputhje me nenin 174 të Statutit) për lëndët nga lëmi i agrobiznesit: Projekte në Agrobiznes, BE-ja dhe Politikat e Përbashkëta Bujqësore, Ekonomiks, Çmimet dhe Tregjet e Produkteve Bujqësore, Ekonomia Bujqësore, Menaxhimi i Fermave, Menaxhim Agrobiznesi, Logjistikë e Avancuar në Agrobiznes.
2. Një asistent (në përputhje me nenin 174 të Statutit) për lëndët nga lëmi i biologjisë: Biologjia e Shtazëve, Biologjia e Bimëve, Gjenetika e Pyjeve, Ekologji e Bimëve dhe Gjeobotanikë, Sistematikë dhe Botanikë e Pyjeve, Mikrobiologjia Ekologjike dhe Monitorimi i Mjedisit.

I. Kushtet dhe dokumentacioni për aplikim

1. Emërimi i personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren. Kandidatët të cilët aplikojnë për mësuesdhënë duhet të kenë së paku gradën, *Doktor i Shkencave* (Dr. sc.), si dhe për pozitën e asistentit gradën *Master* ose *Magjistër* në fushën përkatëse.
2. Kandidatët të cilët aplikojnë për rizgjedhje asistent duhet të jenë të regjistruar në studimet e doktoratës, si dhe rizgjedhja e tyre bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 174 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti".
3. Dokumentacioni për aplikim:
 - Kërkesën dhe CV-në,
 - Kopjen e diplomës përkatëse (për pozitën e mësuesdhënësit diploma e tri niveleve të studimeve; ndërsa për pozitën e asistentit dy nivelet e studimit edhe certifikatën e notave) të noterizuar;
 - Ekstraktin/certifikatën e lindjes (origjinale) dhe kopjen e letërnjoftimit;
 - Dëshminë nga gjykata mbi të kaluarën penale (origjinale);
 - Kandidatët të cilët janë të punësuar në ndonjë institucion të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës duhet të paraqesin edhe vendimin për zgjedhjen e fundit si dhe raportin mbi vlerësimin e performancës (nëse aplikohet).
 - Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale, si dhe informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë;
 - Njohja e gjuhës angleze ose ndonjë gjuhë tjetër është përparësi për aplikantët.
4. Kandidatët që kanë doktoruar, magjistruar ose që kanë mbaruar master jashtë vendit, duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën do të konsiderohet e pakompletuar dosja e aplikantit.
5. Në rast se asnjëri prej kandidatëve nuk i plotëson kriteret ligjore për mësuesdhënë apo asistent të shpallur sipas këtij konkursi, atëherë pozita e njëjtë mbetet e paplotësuar dhe procedura e konkursit do të mbyllet deri në rishpalljen eventuale të së njëjtës.

II. Afati dhe mënyra e aplikimit

1. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në ueb-faqe, përkatësisht deri më datën 18.08.2020 në orën 15:00.
2. Paraqitja e dokumenteve bëhet në njësitë përkatëse akademike duke dorëzuar kopjen fizike si dhe të skanuara në CD, të njëjtën në kopje elektronike e dërgoni edhe në e-mail-in zyrtar: apliko.upz@uni-prizren.com (aplikacioni i dorëzuar vetëm në njërin mënyrë, fizike ose elektronike, nuk shqyrtohet nga komisioni).
3. Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato që janë të pakompletuara apo të parregullta nuk do të pranohen në konkurs (nuk do të shqyrtohen nga komisioni përkatës).
4. Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen zyrtare në këtë adresë: www.uni-prizren.com

III. Procedura e zgjedhjes së kandidatëve dhe e drejta e ankesës

1. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve sipas këtij konkursi dhe e drejta e ankesës realizohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" dhe dispozitat e rregullores nr. 01.111/A për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik (të cilën mund ta gjeni në faqen zyrtare: <https://uni-prizren.com>).


Rektor
Prof. Asoc. Dr. Ismet Temaj

**REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPIJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPIJAN**

Pranuar më: 04.08.2020
Primjeto:

Njësia Jodinicë	Numri Broj	Shënjë Dodatak
4-400	33243	

Njoftimi për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "Emin Duraku"
Komuna: Lipjan
Data: 05.08.2020

Numri i kontratës: ESIP/SDG/023-G/1.3	Emri i kontratës: Vegla për Edukatën Muzikore
---	---

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU "Emin Duraku", Lipjan. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

- Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
 - Vegla për Edukatën Muzikore
- Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
 - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
 - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e SHFMU "Emin Duraku" Lipjan, më së largu deri më 13.08.2020
- Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra, do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues:
Hazbi Sahiti
Telefoni: 044 183-336
E-mail: hazbi.sahiti@hotmail.com

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Ramit Kukaj shpall te pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren

► Senada Abdi shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shf " Leke Dugagjini " Prizren

► Drenusha Xhemajliu shpall te pavlefshme deftesat e kl VI - IX shf " Faik Kornica " Celine

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kom-

pletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

Biznesi "LEO TOBACCO"
Sh.P.K. me NUI: 811442912, me seli në Prizren, me pronar Leotrim Tarashaj, bënë zvogëlimin e kapitalit të biznesit nga vlera prej 100,000 euro, zvogëlohet kapitali në vlerën 10,000 euro.



Contract Title: Supply and Installation of 100 kW of Solar Panels

Publication Reference: 1-2019/413-249

05 August 2020

Hit Flores Sh.P.K, with the address: Sheshi i Deshmoreve, Dragash, 22000, Kosovo, intends to award the contract for: **Supply and Installation of 100 kW of Solar Panels.**

All interested and qualified bidders, national and international, are invited to apply. The tender dossier is available from hit_flores@hotmail.com

The deadline for submission of bids is: 05 September 2020 at 15:00 hours local time at the following address: Hit Flores Sh.P.K, Sheshi i Deshmoreve, Dragash, 22000, Kosovo.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Nr: 01-111-71651

Dt: 04.08.2020

Në bazë të Nenit 8 paragrafi 1 dhe 2, Nenit 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-2012, Nenit 17 paragrafi 1 të Ligjit për Teatrot Nr. 04/L-106 dhe Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komuna e Prizrenit shpall.

KONKURS**Për stafin administrativ së Teatrit të Qytetit “ Bekim Fehmiu “****Institucioni : DKRS/ Teatri i Qytetit “ Bekim Fehmiu “ – Prizren****1. Titulli i pozitës : Inspicienti**

Nr. i pozitave : 1 (një)

Grada / koeficienti : 7

I përgjigjet : Drejtorit të teatrit

Orari i punës : I plotë 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Inspicienti duhet të ketë përfunduar parapregaditjet për fillimin e provave, 30 minuta para fillimit të provës;
- Shënimi i simbolikës së praktikuar në librin për mbajtjen e shfaqjeve për të gjitha veprimet që duhet kryer;
- Harmonizon punën dhe aktivitetet e përpëritësit të ndriqimit dhe të personelit skeniko- teknik;
- Kujdeset për ndrrimin e dekorit dhe kontrollimin e skenës;
- Kujdeset për sigurimin e kushteve për zhvillimin normal të provave dhe shfaqjeve;
- Kryen edhe punë tjera nga fushëveprimi i vet dhe punët e caktuara nga mbikqyrësi i drejtpërdrejtë;

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara :

- Të ketë të kryer një fakultet nga arti skenik;
- Përvojë pune së paku 3 (tre) vite (punë aktive në teatër);
- Njohje e punës praktike në realizimin e shfaqjeve teatrale;

Dokumentet e kërkuara :

- Dëshmi të kualifikimit shkollor e noterizuar, nëse kandidati ka kryer fakultetin jashtë Rrepublicës së Kosovës diploma duhet të jetë e nostrifikuar nga MASHT;
- Dëshmi mbi përvojën e punës ;
- CV-në e tij/saj ;
- Dokument Identifikimi ;
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime .

Institucioni : DKRS/ Teatri i Qytetit “ Bekim Fehmiu “ – Prizren**2. Titulli i pozitës : Financier**

Nr. i pozitave : 1 (një)

Grada / koeficienti : 7

I përgjigjet : Drejtorit të teatrit

Orari i punës : I plotë 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Planifikimi i buxhetit të teatrit;
- Koordinon politikën buxhetore në bashkëpunim me drejtorin e Teatrit ;
- Zbaton politikat buxhetore të aprovuara në bazë të ligjit për menaxhimin e financave publike;
- Kontrollon dhe harmonizon buxhetin e teatrit në bazë të kornizës buxhetore ;
- Bën shpenzimin e buxhetit në harmoni me planet e teatrit ;
- Përgadit raportet financiare të teatrit ;
- Përgadit marrëveshje bashkëpunimi me personat e angazhuar në projekte teatrale ;
- Përgadit dhe raporte tjera të Teatrit sipas kërkesa të drejtorit të Teatrit duke u bazuar në ligjin për menaxhimin e financave publike ;
- Bashkëpunon ngusht me Drejtorinë e Financave në komunë sepse të gjitha pagesat kryhen nëpërmjet komunës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara :

- Fakultetit ekonomik;
- Të ketë së paku 1 vjet përvojë pune;
- Njohja e punës praktike administrative;
- Njohja e punës me kompjuter Word,Excel etj.

Dokumentet e kërkuara :

- Dëshmi të kualifikimit shkollor e noterizuar, nëse kandidati ka kryer fakultetin jashtë Rrepublicës së Kosovës diploma duhet të jetë e nostrifikuar nga MASHT;
- Dëshmi mbi përvojën e punës ;
- CV-në e tij/saj ;
- Dokument Identifikimi ;
- Referenca të punës
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime .

Institucioni : DKRS/ Teatri i Qytetit “ Bekim Fehmiu “ – Prizren**3. Titulli i pozitës : Zyrtar/e për marrëdhënie me publikun**

Nr. i pozitave : 1 (një)

Grada / koeficienti : 7

I përgjigjet : Drejtorit të teatrit

Orari i punës : I plotë 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Komunikon me media locale dhe Kombëtare lidhur me qeshjet që I takon Teatrit;
- Përpilon njoftime për shtyp;
- Organizon kampanja për shfaqje teatrale;
- Menaxhon rrjetet sociale të teatrit;
- Sipas nevojës kryen edhe punë tjera lidhur me fushën e komunikimit.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara :

- Të ketë të kryer fakultetin filologjik/gazetarisë ;
- Përvojë pune së paku 2 (dy) vite;
- Njohje e punës praktike në realizimin e marketingut;

Dokumentet e kërkuara :

- Dëshmi të kualifikimit shkollor e noterizuar, nëse kandidati ka kryer fakultetin jashtë Rrepublicës së Kosovës diploma duhet të jetë e nostrifikuar nga MASHT;
- Dëshmi mbi përvojën e punës ;
- CV-në e tij/saj ;
- Dokument Identifikimi ;
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime .

Institucioni : DKRS/ Teatri i Qytetit “ Bekim Fehmiu “ – Prizren**4. Titulli i pozitës : Dekorateri**

Nr. i pozitave : 1 (një)

Grada / koeficienti : 6

I përgjigjet : Drejtorit të teatrit

Orari i punës : I plotë 40 orë

në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Pastrimi i skenës dhe përgaditja e saj për provë apo ndonjë pune tjetër sipas orarit të punës në skenë;
- Vënia e dekorit të tërësishëm për pjesë ose program dhe ndrrimet gjatë provave dhe shfaqjeve;
- Përgaditja e punëve për vënien e dekorit të ri duke filluar nga praktikabla dhe dyshemeja e butë e gjerë të hintergrundi, elemente anësore dhe varëse;
- Ngritja dhe lëshimi i cugave;
- Kryen edhe punë tjera nga fushëveprimi i vet dhe punët e caktuara nga mbikqyrësi i drejtpërdrejtë, poashtu edhe nga drejtori i Teatrit.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara :

- Duhet të ketë të kryer shkollën e mesme;
- Së paku 3 (tre) vite përvojë pune në institucion të teatrit;
- Njohja e punës praktike sa i përket dekorit ;

Dokumentet e kërkuara :

- Diploma e shkollës së mesme e noterizuar;
- Dëshmi mbi përvojën e punës ;
- CV-në e tij/saj ;
- Dokument Identifikimi ;
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime .

5. Titulli i pozitës : Gardarobieri

Nr. i pozitave : 1 (një)

Grada / koeficienti : 6

I përgjigjet : Drejtorit të teatrit

Orari i punës : I plotë 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Gardarobieri kujdeset për klasifikimin e gardarobës , stolive, këpucëve në numërzimin e tyre, rregullimin, depozitimin dhe mirëmbajtjen e tyre;
- Kujdeset për pastërtinë e dhomës së tërësishme të gardarobës dhe këpucëve;
- Kujdeset për larjen (këmisha, nënkëmisha, bregë, kravat, qorapat dhe të gjitha elementet e gardarobës të cilat në pikëpamje higjienike duhet të jenë të pastërta (të lahen, teren, hekurosen) dhe të kthehen në garderobë;
- Hekuros të gjitha elementet e gardarobës të cilat në pjesën teatrale kërkohen të jenë të hekurosura dhe atë për çdo shfaqje teatrale;
- I ndihmonë aktorëve dhe statistëve të përgaditen për dalje në skenë dhe ndihmonë edhe në veshjen e tyre;
- Paketon garderobën dhe këpucët e nevojshme për shfaqjet në teren dhe pjesëmarrësit si mysfair (që ngarkon dhe shkarkon garderobën);
- Paraqet çfardo elementi të humbur të gardarobës ose të këpucëve si dhe dëmtimin e tyre;
- Kryen edhe punë tjera nga fushëveprimi i vet, edhe gjatë kohës së qëdrimit të Teatros në teatrin “ Bekim Fehmiu “ ;
- Kryen edhe detyra tjera për stafin administrative, artistik dhe teknik që urdhërohen nga drejtori i Teatrit

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkua :

- Duhet të ketë të kryer shkollën e mesme;
- Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në institucion të teatrit;
- Të njoh punën praktike të gardarobës ;

Dokumentet e kërkua :

- Diploma e shkollës së mesme e noterizuar;
- Dëshmi mbi përvojën e punës ;
- CV-në e tij/saj ;
- Dokument Identifikimi ;
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime .

6. Titulli i pozitës : **Teknik i Skenës dhe mirëmbajtës i ngrohjes**

Nr. i pozitave : 1 (një)

Grada / koeficienti : 6

I përgjigjet : Drejtorit të teatrit

Orari i punës : I plotë 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Përgadit skenën nga ana teknike;
- Rregullimin dhe mirëmbajtjen e skenografisë, po ashtu edhe në realizimin e saj në bazë të dizajnit nga ana e skenografit;
- Dorëzimin e skenografisë në gjendje të rregullt dhe dorëzimin e saj deri te dekorateri;
- Mirëmbajtjen e makinave punuese të drurit, hekurit dhe materialeve tjera;
- Kryen edhe punë tjera të rekomanduara nga inspicienti dhe drejtori i Teatrit;
- Mbikqyr dhe kujdeset për sistemin e aparaturave të ftohjes dhe ngrohjes së ambienteve në godinën e Teatrit (salla, skena, holli, zyret etj);
- Raporton për ndonjë defekt eventual të sistemit të ngrohjes dhe ftohjes dhe servisimin e saj;
- Kryen edhe punë të tjerë konform rregulloreve po ashtu edhe me urdhëresë të drejtorit të Teatrit;

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkua :

- Duhet të ketë të kryer shkollën e mesme;
- Së paku 2 (dy) vite përvojë pune si teknik skene;
- Të ketë njohuri të punës praktike në skenë ;

Dokumentet e kërkua :

- Diploma e shkollës së mesme e noterizuar;
- Dëshmi mbi përvojën e punës ;
- CV-në e tij/saj ;
- Dokument Identifikimi ;
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime .

7. Titulli i pozitës : **Teknik i ndriqimit dhe zërimit**

Nr. i pozitave : 1 (një)

Grada / koeficienti : 6

I përgjigjet : Drejtorit të teatrit Orari i punës : I plotë 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Përgaditjen dhe kujdesin e teknikës së ndriqimit dhe zërimit;
- Mirëmbajtjen e tyre ;
- Përgaditje për fillimin e punës ;
- Dizajnimin e dritave (reflektorëve) dhe të zërimit në bazë të kërkesave të regjisorit të shfaqjes;
- Pjesëmarrjen dhe realizimin e dritave gjatë provave, premierës dhe reprizave;
- Merr pjesë me detyrat e tij në çdo vend ku do të realizohen reprizat e shfaqjes në Kosovë dhe jasht saj ;
- Kryen punë të tjera nga fushëveprimi i vet dhe punë të caktuara nga drejtori i Teatrit;

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkua :

- Duhet të ketë të kryer shkollën e mesme;
- Së paku 3 (tre) vite përvojë pune si teknik ndriqimit dhe zërimit ;
- Njohja e punës praktike në miksetë digjitale të ndriqimit ;
- Njohja e punës praktike në sistemin elektrik.

Dokumentet e kërkua :

- Diploma e shkollës së mesme e noterizuar;
- Dëshmi mbi përvojën e punës ;
- CV-në e tij/saj ;
- Dokument Identifikimi ;
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime .

8. Titulli i pozitës : **Shitës i biletave dhe rekuiziteri**

Nr. i pozitave : 1 (një)

Grada / koeficienti : 6

I përgjigjet : Drejtorit të teatrit

Orari i punës : I plotë 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Identifikimi, mbledhja, gjetja, realizimi dhe furnizimi i rekuizitave të një shfaqje sipas kërkesave të regjisorit dhe skenografia;
- Mirëmbanë, ruan dhe përkujdeset për të gjitha rekuizitat e shfaqjeve në repertori dhe atyre të mëhershme;
- Regjistron rekuizitat në stok dhe përpilon listën e tyre gjatë gjithë kohës;
- Bashkëpunon ngusht me realizatorët e skenografisë, inspicientin, skenografinë dhe regjisorin e shfaqjes;
- Përcjell provat e shfaqjes sipas kërkesave të inspicientit dhe regjisorit duke asistuar në identifikimin dhe ofrimin e rekuizitave të nevojshme për prova ;
- Përcjell orarin e shfaqjeve dhe përgadit para çdo prove dhe shfaqje rekuizitat të tyre;
- Asiston prapa perdeve në rast nevojë për aktorët duke orfuar rekuizitat e nevojshme;
- Bën rezervimin dhe shitjen e biletave të shfaqjeve të teatrit;
- Identifikon dhe mban përgjegjësi për numrat serik të biletave;
- Kryen edhe punë tjera në bazë të udhëzimeve të drejtorit të Teatrit.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkua :

- Duhet të ketë të kryer shkollën e mesme;
- Së paku 3 (tre) vite përvojë pune për aktivitete në teatër ;
- Njohja e punës praktike për përdorimin e veglave të punës për realizimin e rekuizitave .

Dokumentet e kërkua :

- Diploma e shkollës së mesme e noterizuar;
- Dëshmi mbi përvojën e punës ;
- CV-në e tij/saj ;
- Dokument Identifikimi ;
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime .

9. Titulli i pozitës : **Pastrues/e**

Nr. i pozitave : 1 (një) Grada / koeficienti : 5

I përgjigjet : Drejtorit të teatrit

Orari i punës : I plotë 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Pastrimin dhe mirëmbajtjen e pastërtisë, higjienës në të gjitha hapësirat e godinës së Teatrit (Sallën, skenën, zyret, dhomat, garderobën, dhomën e grimerës, hollin, banjot, ËC-të, dritaret etj).
- Të bëjë kërkesë për material higjienike;
- Tubimin dhe nxjerrjen e mbeturinave nga ambienti, futjen e tyre në qese të posatshme, nxjerrjen jasht ambientit në vendin e përcaktuar për mbeturina;
- Të kryej edhe punë të tjera të caktuara nga drejtori i Teatrit .

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkua :

- Duhet të ketë të kryer shkollën fillore;
- Së paku 2 (dy) vite përvojë pune;
- Njohja e punës praktike në pastrimin e hapësirës publike .

Konkursi ngel i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit, duke filluar nga data e publikimit më **04.08.2020** deri më datën **18.08.2020** që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. **Instruksione Aplikimi:** Kërkesa (Aplikacioni) për punësim gjendet në [https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konkurset-njoftimet/aplikacione/dhe-pas-plotësimit-sipas-çdo-pike-të-aplikacionit,-bashkëngjitni-dokumentet-të-cilat-kërkohen-sipas-konkursit-dhe-mund-të-aplikoni-tek-ne-drejtëpërdrejtë-Adresa-jonë:-në-sportelin-e-pranimit-në-objektin-e-administratës-komunale-në-Komunën-e-Prizrenit,-rr.-"Remzi-Ademaj"](https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konkurset-njoftimet/aplikacione/dhe-pas-plotësimit-sipas-çdo-pike-të-aplikacionit,-bashkëngjitni-dokumentet-të-cilat-kërkohen-sipas-konkursit-dhe-mund-të-aplikoni-tek-ne-drejtëpërdrejtë-Adresa-jonë:-në-sportelin-e-pranimit-në-objektin-e-administratës-komunale-në-Komunën-e-Prizrenit,-rr.-) p.n. -Prizren. **VËMENDJE:** Njoftimet i gjeni në Ueb, ndërsa në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038 / 200 44715 prej orës 08:00 –16:00. Aplikacionet e pranuar pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve. Konkursi është i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu siç parashihet me Ligjislacionin në fuqi.



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Nr. 01-111-72170

Datë: 04.08.2020

Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Komuna e Prizrenit, shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale/Shtëpia e Komunitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara

Titulli i pozitës së punës: Infermier

Lloji i vendit të punës: me afat të pacaktuar, me orar të plotë (periudha provuese 6 muaj)

Koeficienti: **H-53**,

Numri i Ekzekutuesve: **5**

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS:

- Gjatë orarit të ditës apo gjatë kujdestarisë është i/e obliguar të dijë saktë numrin e klientëve dhe gjendjen shëndetësore të tyre në repartin ku ai/ajo punon si dhe të bëjë evidentimin e tyre në raportin ditor dhe të raportoj te infermieri përgjegjës i repartit.
- Ka përgjegjësi në mbikëqyrjen e gjendjes shëndetësore të klientëve, shpërndarjen e terapisë së rregullt eventuale sipas përshkrimit të mjekut apo neuropsikiatrit dhe evidentimin e tyre.
- Bën pastrimin dhe lidhjen e plagëve si dhe evidentimin e tyre.
- Është përgjegjës për higjienën personale të klientëve, repartit dhe për veshmbathjen e tyre, po ashtu ka për detyrë të përcjell klientët gjatë shujtës së ushqimit.
- Punon ngushtë me mjekun dhe neuropsikiatrin, kryeinfermierin dhe infermierin përgjegjës duke raportuar mbi gjendjen shëndetësore dhe ndryshimet eventuale rreth klientëve ;
- Punon në mënyrë aktive dhe të drejtpërdrejt me mjekun, kryeinfermierin, infermieret përgjegjës të repartëve, punëtorin sociale dhe profesionistët tjerë në përmirësimin e gjendjes së pacientëve përmes aktiviteteve rehabilituese dhe rekreative;
- Bën transportin e klientëve jashtë institucionit për shërbime tjera mjekësore sipas përshkrimit të mjekut;
- Ka përgjegjësi në përshkrimin e raporteve ditore dhe raporton tek infermieri përgjegjës, kryeinfermieri dhe mjeku për punën dhe aktiviteteve gjatë 24 orëve
- Përgadit raporte javore, mujore dhe vjetore;
- Bashkë me stafin tjetër gjatë ndërrimit përgatit dhe servon ushqimin për klientët;

Kushtet:

Shkolla e mesme e mjekësisë së përgjithshme, infermierisë ose Fakulteti i infermierisë Përvojë pune së paku 6 muaj ose praktika profesionale e kryer

Shkathtësitë e kërkuara:

- Aftësi për të komunikuar si verbalisht ashtu edhe me shkrim,
- Aftësi dhe shkathtësi profesionale,
- Aftësi në përdorimin e pajisjeve mjekësore,
- Posedimi i patentshoferit (e preferueshme)
- Njohje e mirë e punës me kompjuter (Microsoft Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

Dokumentacioni i kërkuar:

- Fotokopja e Letërnjoftimit
- Ekstrakti i lindjes
- Dy - rekomandime (nëse keni)
- Diploma e Shkollës së mesme (kopja e vërtetuar)
- Vërtetim për përvojën e punës së bashku me pasqyrën nga TRUST/dëshmi mbi praktikën profesionale
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime

Titulli i pozitës së punës: Ndhimës Infermier/e

Lloji i vendit të punës: me afat të pacaktuar, me orar të plotë (periudha provuese 6 muaj)

Koeficienti: **H-60**,

Numri i Ekzekutuesve: **5**

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS:

- Kujdeset për higjienën e klientëve te ndihmoj ne pastrimin e tyre si dhe te bej pastrimin e atyre qe nuk mund te pastrohen vet për shkak te gjendjes se rend shëndetësore dhe e raporton infermierin përgjegjës dhe infermierin e ndërrimit.
- Ka për detyrë të bëjë rregullimin e shtretërve dhe të repartit si dhe pastrimin e tyre.
- Në bashkëpunim me infermierin prganizojnë dërgimin e klientëve në restorantin e kuzhinës dhe bëjnë shpërndarjen e ushqimit për klientët në nevojë si dhe u ndihmojnë në të ushqyer atyre që nuk mund të ushqehen vet.
- Përgadit klientët në mëngjes dhe në mbrëmje si dhe u ndihmon në veshëmbeathjen e tyre.
- Bën ndërrimin e pampersave të klientëve si dhe I përgadit për gjumë në mbrëmje duke ju a pastruar kembët dhe duke ja rregulluar shtratin
- Bën përcjelljen e klientëve dhe merr pjesë ne terapinë e punës dhe të rehabilitimit në bashkëpunim me infermierët.
- Ndihmon infermieret në transportimin e rasteve jashtë institucionit
- Kryen edhe punë tjera sipas nevojave të klientëve
- Përgadit raporte javore, mujore dhe vjetore.
- Bashkë me stafin tjetër në ndërrim bënë edhe përgatitjen dhe servimin e ushqimit për klientët.

Kushtet:

Shkolla e mesme e mjekësisë së përgjithshme, infermierisë, Fakulteti i infermierisë Përvojë pune së paku 6 muaj ose praktika profesionale e kryer

Shkathtësitë e kërkuara:

- Aftësi për të komunikuar si verbalisht ashtu edhe me shkrim,
- Aftësi dhe shkathtësi profesionale,
- Aftësi në përdorimin e pajisjeve mjekësore,
- Posedimi i patentshoferit (e preferueshme)
- Njohje e mirë e punës me kompjuter (Microsoft Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

Dokumentacioni i kërkuar:

- Fotokopja e Letërnjoftimit
- Ekstrakti i lindjes
- Dy - rekomandime (nëse keni)
- Diploma e Shkollës së mesme (kopja e vërtetuar)
- Vërtetim për përvojën e punës së bashku me pasqyrën nga TRUST/dëshmi mbi praktikën profesionale
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime

Konkursi ngel i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit, duke filluar nga data e publikimit më **04.08.2020** deri më datën **18.08.2020** që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. **Instrukione Aplikimi:** Kërkesa (Aplikacioni) për punësim gjendet në <https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konkurset-njoftimet/aplikacione/dhe-pas-plotësim-it-sipas-çdo-pike-të-aplikacionit-i-bashkëngjitni-dokumentet-të-cilat-kërkohen-sipas-konkursit-dhe-mund-të-aplikoni-tek-ne-drejtpërdrejtë-Adresa-jonë-në-sportelin-e-pranim-it-në-objektin-e-administratës-komunale-në-Komunën-e-Prizrenit,-rr.-Remzi-Ademaj-p.n.-Prizren>. **VËMENDJE:** Njoftimet i gjeni në Ueb, ndërsa në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038 / 200 44715 prej orës 08:00 –16:00. Aplikacionet e pranuar pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve. Konkursi është i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu siç parashihet me Ligjislacionin në fuqi.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales